

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5947
E premte, 6 dhjetor 2019
çmimi 0.40€

Shumica e qytetarëve
pëlqejnë që taksa 100 %
të mbetet në fuqi | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

**SHITJA, AFTËSI
E DOMOSDOSHME
NË ÇDO PROFESION** F. 5

SHKRUAN:
GENTRIT
KADROLI



AKTUALE



**GJERMANIA NË JANAR DËRGON
ZYRTARËT NË KOSOVË PËR TA
SHOYRTUAR NJOHJEN E
PATENTSHOFERËVE** F. 5

**GJENDEN MBETJE MORTORE NË
MITROVICË TË VERIUT** F. 3

**BESIMTARËT MYSLIMANË NË
KOSOVË MBLODHËN MBI 300
MIJË EURO PËR SHOQPËRINË** F. 7

EKONOMI



**KOSOVA MUND TA NISË VITIN
2020 PA BUXHET** F. 9

**ÇMIMET E IMPORTIT U NGRITËN
PËR 2.1 PËR QIND** F. 9

SPORT

**MILICAJ: MBIJETESA, MISION I
VËSHITËRË PËR DUKAGJININ** F. 16

FLET PËR "EPOKËN E RE", AGIM BAHTIRI | FAQE 4-5

MUND TË SHKOJME NË ZGJEDHJE, POR MPB-në S'E JAPIM



Anëtari i Këshillit të Përgjithshëm i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Agim Bahtiri, ka bërë me dije se kjo parti në asnjë mënyrë nuk do t'ia japë Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB). Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re",

kryetari i Mitrovicës ka thënë se LV-ja është e gatshme të shkojë sërish në zgjedhje të reja, por nuk do ta lëshojë këtë ministri. Sipas tij, MPB-ja lidhet me premtimet kryesore të kësaj partie që ka bërë gjatë fushatës zgjedhore për rend dhe ligj. Ai ka deklaruar se MPB-ja është pika

kryesore e ndryshimit të gjendjes në Kosovë. Ndërkaq sa i përket postit të presidentit, Bahtiri ka thënë se nuk është koha që të diskutohet për këtë çështje. Ai beson se koalicioni qeverisës në mes të LV-së dhe LDK-së do të arrihet sepse, sipas tij, nuk ka alternativë tjetër

Ligji për paga shkon në Gjykatën Kushtetuese



Avokati i Popullit ka bërë me dije se ka pranuar 35 ankesa nga subjekte të ndryshme të sektorit publik të parashtruara kundër Ligjit për paga në sektorin publik, duke përfshirë këtu ankesat nga të punësuarit në shëndetësi, në arsim, në polici dhe në shërbimin civil. Për këtë arsye, Avokati i Popullit të enjten i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për ta vlerësuar kushtetueshmërinë e Ligjit për paga | FAQE 7

Rreth 100 mijë vaksina kundër gripit arrijnë sot në Kosovë

 F. 7

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Pacolli në Thumanë me Ramën, premtori pallat në Krujë për 3 muaj

TRANË, 5 DHJETOR - Kryeministri Edi Rama vizitoi familjet e prekura në Thumanë. Ai u shoqërua nga ministri i Jashtëm i Kosovës Behgjet Pacolli dhe deputetja Eglantina Gjermeni.

Në takim Pacolli, i cili ka dhuruar 1 milion euro për të prekurit nga tërmeti i 26 nëntorit në Shqipëri, tha se do të ndërtojë vetë banesa për ata që mbetën pa çati në kokë. "Aty ku ka pallate mirë është me zbrit poshtë, për të hapur hapësirë, se Kruja është qytet turistik. Vendosim dhe një fond ne dhe

bëjmë një operacion që të dalë edhe qyteti i fituar. Rregullon kualitetin e jetës, më mirë në rrafsh ku krijohet një infrastrukturë tjetër, që ka afër shkollën e kopshtin", tha Pacolli.

Pacolli tha se ka nisur nga puna për të bërë projektin e pallateve, ndërsa tha se nëse nuk krijohen pengesa, ata do të jenë gati për 3 muaj.

"Nëse nuk ka pengesa në rastin më të mirë, një pallat, 45 banesa nga 80 metra katrorë, për 3 muaj duhet të kryhet", tha Pacolli.

Ndërsa kryeministri shqiptar, Edi Rama në mbledhjen e jashtëzakonshme të qeverisë tha se po lëviz në kërkim të lekëve, pasi buxheti është i dobët, por edhe këtë tragjedi zor se edhe shtete të forta e përballojnë vetëm.

Rama ka premtuar ngritjen e lagjeve të reja në Tiranë, Laç e Durrës pas shembjes së gjithë banesave e pallateve të dëmtuara rëndë nga tërmeti i 26 nëntorit. Në mbledhjen e së enjtes, kreu i qeverisë tregoi disa prej zjonave ku do të vendosen lagjet e reja.



Thaçi: Duhet të denoncohen politikat gjenocidale të Serbisë

Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi duke reaguar ndaj deklaratës së presidentit të Serbisë për masakrën e Reçakut, ka thënë se paqja, pajtimi, drejtësia nuk mund të ndërtohen bazuar në mohimin e krimeve dhe politikat serbe të gjenocidit duhet të denoncohen

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ka reaguar pas deklaratës së presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i cili e quajti masakrën e Reçakut "një trillim".

Presidenti Thaçi përmes një postimi në rrjetin social "Twitter" ka shkruar se "paqja, pajtimi, drejtësia nuk mund të ndërtohen bazuar në mohimin e krimeve".

"Disa zyrtarë nga Serbia mohojnë disa nga krimet më të rënda kundër civilëve që ndodhën në Evropë, sikurse ishte Reçaku, të konfirmuara edhe nga Gjykata e Hagës për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi. Politikat serbe të gjenocidit nuk mund të mbrohen. Ato duhet të denoncohen. Paqja, pajtimi, drejtësia nuk mund të ndërtohet bazuar në mohimin e krimeve", ka shkruar Thaçi.

Të enjten, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, deklaroi se sa i përket Reçakut në vitin 1999 "bëhet fjalë për krim të trilluar, dhe se gjithçka ishte trillim i një mashtruesi, siç është Èilliam

Èolker".

"Këtë do ta përsëris çdo ditë dhe të shohim se kush do të na gjykojë", tha Vuçiqi.

Ndërkaq, kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, tha përmes një postimi në rrjetin social Facebook, se "është për keqardhje se si Serbia, që konsiderohet si shtet favorit nga BE-ja, vazhdon ta kultivojë urrejtjen etnike ndaj shqiptarëve dhe mohon krimet gjenocidale të saj".

"Urrejtja patologjike e Vuçiqit ndaj shqiptarëve, po dëshmohej edhe me deklarinimin e tij të fundit, "se masakra e Reçakut e cila tronditi mbarë botën në vitin 1999 është e fabrikuar".

Ky qëndrim dëshmon qartë se Serbia edhe në formë institucionale e ruan paturpësisht mendësinë kriminale të trashëguar nga koha e Millosheviqit.

Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera dhe urrejtja ndaj secilës etni është vepër e dënueshme me ligj.



Është për keqardhje se si Serbia, që konsiderohet si shtet favorit nga BE-ja, vazhdon ta kultivojë urrejtjen etnike ndaj shqiptarëve dhe mohon krimet gjenocidale të saj, duke kontaminuar kështu të ardhmen e tyre dhe duke zvogëluar shanset për paqe dhe pajtim në rajon", ka thënë Haradinaj.

Edhe ambasadorja e Republikës së Kosovës në Uashington, Vlora Çitaku, ka reaguar ndaj presidentit serb. Ajo ka thënë se deklarata e Vuçiqit për masakrën e Reçakut

është çmenduri.

"Presidenti i Serbisë sapo ka deklaruar që masakra e Reçakut është një krim i fabrikuar. Kjo është një çmenduri totale".

"Reçaku ishte një tragjedi e cila shpalohej dhe zbuloi para syve të botës egërsinë e vërtetë të regjimit serb në Kosovë", ka shkruar Çitaku në llogarinë e vet në "Twitter".

Çitaku ka thënë se deklarata të tilla janë një turp për Serbinë dhe se mohimi i krimeve të kryera nga forcat serbe është i

papranueshëm.

Masakra e Reçakut, njihet si një nga ngjarjet që ka shënuar kthesë në diplomacinë ndërkombëtare në raport me Serbinë dhe Kosovën, duke u paraprirë proceseve që çuan te fushata e bombardimeve të NATO-s kundër caqeve ushtarake të Serbisë.

Vrasja e 45 civilëve shqiptarë nga forcat paramilitare serbe në Reçak ishte cilësuar "krim kundër njerëzimit" nga ish-shëfë i Misionit Verifikues në Kosovë, ambasadori William Walker.

Macroni propozon konferencë ndërkombëtare për ta ndihmuar Shqipërinë



Paris, 5 dhjetor - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka propozuar organizimin e një konference ndërkombëtare për ta ndihmuar Shqipërinë të përballë me pasojat e tërmetit shkatërrues të 26 nëntorit.

"Na duhet një konferencë soli-

dariteti për Shqipërinë", tha kreu i shtetit francez pas samitit të NATO-s në Watford.

Sipas Macronit, konferenca që do të organizohet nga Franca do të ndihmonte në mobilizimin e partnerëve publikë dhe privatë për të organizuar

rindërtimin e objekteve të shkatërruara.

Tërmeti shkatërrimtar i 26 tetorit u shndërrua në një tragjedi të rëndë, duke lënë 52 viktima, afro 1 mijë të plagosur dhe mijëra persona tjerë të pastrehë.

KDI-ja publikon të gjeturat kryesore të sondazhit të nëntë të opinionit publik "Këndvështrimi i qytetarëve për temat potenciale të marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi"

Shumica e qytetarëve pëlqejnë që taksa 100 % të mbetet në fuqi

Sondazhi i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) shpalos këndvështrimin qytetar lidhur me çështjet kryesore rreth së ardhmes së procesit të dialogut siç janë: taksa 100 % ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës, teza e korigjimit të kufijve, asociacioni i komunave me shumicë serbe si dhe temat potenciale që qytetarët presin të jenë pjesë e procesit të dialogut Kosovë - Serbi. Lidhur me çështjen nëse qeveria duhet të pezullojë këtë masë për t'i hapur rrugë dialogut me Serbinë, shumica e qytetarëve, përkatësisht 59 për qind e tyre, kanë vlerësuar se qeveria e ardhshme nuk duhet ta pezullojë taksën për t'i hapur rrugë dialogut me Serbinë



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar sot të gjeturat kryesore të sondazhit të nëntë të opinionit publik "Këndvështrimi i qytetarëve për temat potenciale të marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi". Ky sondazh shpalos këndvështrimin qytetar lidhur me çështjet kryesore rreth së ardhmes së procesit të dialogut siç janë: taksa 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës, teza e korigjimit të kufijve, asociacioni i komunave me shumicë serbe si dhe temat potenciale që qytetarët presin të jenë pjesë e procesit të dialogut Kosovë - Serbi.

Aktualisht Kosova ndodhet para krijimit të institucioneve të reja qeverisëse dhe çështja e taksës do të jetë një ndër temat të cilat mbeten të ndërlydhura me procesin e dialogut për shkak të kushtëzimit të vazhdimet të këtij procesi me heqjen e taksës nga ana e Serbisë.

Lidhur me çështjen nëse qeveria duhet të pezullojë këtë masë për t'i hapur rrugë dialogut me

Serbinë, shumica e qytetarëve, përkatësisht 59 për qind e tyre, kanë vlerësuar se qeveria e ardhshme nuk duhet ta pezullojë taksën për t'i hapur rrugë dialogut me Serbinë. Sipas përkatësisë etnike, këtë mendim e ndajnë 61 për qind e të anketuarve nga komuniteti shqiptar, 56 për qind e të anketuarve nga komunitetet e tjera joshumicë dhe 10 për qind e të anketuarve nga komuniteti serb.

Ideja e 'korigjimit të kufijve' e shpalosur në opinion nga presidenti Thaçi në vitin 2017 pati interpretime të shumta se çfarë do të thotë kjo tezë dhe cilat do të mund të ishin implikimet e saj. Në shumësinë e interpretimeve nevoja për qartësimin e kësaj teze mbetet e evidente.

Në bazë të këtij hulumtimi të opinionit publik del në pah se rreth 45 për qind e të anketuarve janë shprehur se e kanë të qartë se çfarë nënkupton teza "korigjim i kufijve", ndërsa 31 për qind e tyre e kanë deri-diku të qartë dhe 20 për qind e të anketuarve nuk e kanë të paqartë se çfarë nënkupton kjo tezë. Sipas përkatësisë etnike, këtë nocion e kanë të qartë 47 për qind e të

anketuarve nga komuniteti shqiptar, 20 për qind e të anketuarve nga komuniteti serb dhe 23 për qind e të anketuarve nga komunitetet e tjera joshumicë.

Temë e cila pati interpretime të ndryshme rreth formatit të saj dhe implikimeve të mundshme në funksionimin e shtetit të Kosovës, duke shkaktuar polarizim politik në vend, ishte dhe asociacioni i komunave me shumicë serbe. Në këtë hulumtim del në pah se sa e kuptojnë qytetarët se çfarë nënkuptohet me 'asociacioni i komunave me shumicë serbe me kompetenca ekzekutive'. Janë 39 për qind e qytetarëve të cilët janë shprehur se e kanë të qartë se çfarë nënkuptohet me "asociacioni i komunave me shumicë serbe me kompetenca ekzekutive".

Ndërsa 29 për qind e tyre janë deklaruar se e kanë të paqartë dhe 27 për qind e tyre janë shprehur se e kanë deri-diku të qartë.

Në baza etnike, në nivel më të lartë qytetarët nga komuniteti shqiptar me 41 për qind e kanë të qartë çfarë nënkuptohet me "asociacioni i komunave me shumicë serbe me kompetenca ekzekutive", kundrejt 26 për qind të qytetarëve nga komuniteti serb dhe 17 për qind e qytetarëve nga komunitetet e tjera joshumicë.

Aktualisht procesi i dialogut vazhdon të mbetet i pezulluar dhe e ardhmja e këtij procesi mbetet e paqartë. Ende nuk dihen temat të cilat do të diskutohen në kuadër të këtij procesi dhe të cilat do të mund të jenë pjesë e një marrëveshjeje potenciale gjithëpërfshirëse ligjërisht të obligueshme në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Sipas qytetarëve të anketuar, disa nga elementet më të rëndësishme që, sipas tyre, duhet të përfshijë marrëveshja Kosovë - Serbi janë të pagjeturit (71 për qind), dënimet për krime të luftës

(60 për qind), dëmshpërblimet e luftës (59 për qind), kërkimfalja (56 për qind), kthimi i fondit (41 për qind) dhe me 38 për qind është vlerësuar njohja reciproke. Megjithatë, janë shpërfaqur dallime në mes të qytetarëve nga komunitetet e ndryshme lidhur me elementet që duhet të përmbajë marrëveshja Kosovë - Serbi. Ky hulumtim i opinionit publik është realizuar në periudhën kohore 2 deri më 8 shtator 2019, me një mostër përfaqësuese prej 1 070 respondentësh në nivel vendi, nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Margjina e gabimit ±3 për qind në përzgjedhje për interval të konfidencës 95 për qind. Ky hulumtim i opinionit publik është realizuar në kuadër të projektit "Perspektiva evropiane - ndërtimi i konsensusit kombëtar për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë" që përkrahet nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë.

Gjenden mbetje mortore në Mitrovicë të Veriut

MITROVICË, 5 DHJETOR - Autoritetet e Kosovës konfirmuan se gjatë gërmimeve në brendësi të hapësirës së varrezave të komunitetit mysliman në Mitrovicë të Veriut kanë gjetur të mërkurën mbetje mortore të së paku dy personave, që dyshohet se janë viktime të luftës së fundit në Kosovë dhe janë në listën e personave të pagjetur deri më tash. Lajmin e ka bërë me dije për "Radion Evropa e Lirë" Kushtrim Gara, nga Komisioni Qeveritar për Persona të Pagjetur. "Në zbatim të urdhërësës së Prokurorisë Speciale të Republikës së



Kosovës janë realizuar gërmimet e nevojshme, të cilat kanë rezultuar me gjetjen dhe zhvarrosjen

e pjesëve kockore të së paku dy personave. Në procedurën e mëtutjeshme, në kuptimin e

ekzaminimeve mjeko-ligjore, përfshirë edhe identifikimin përmes analizës së ADN-së, do të mund të përcaktohet numri i personave të zhvarrosur si dhe identiteti i tyre", ka deklaruar Gara.

Në vendin ku janë gjetur këto mbetje kockore ekipe të caktuara të mjekësisë ligjore të Kosovës edhe dy herë më parë kanë bërë gërmime, duke gjetur mbetje mortore të një personi. Autoritetet e Kosovës gjatë vitit 2019 kanë kryer gërmime në 26 lokacione brenda territorit të Kosovës, të dyshuara për varreza

masive.

Gërmimet, javën e kaluar, në kompleksin universitar në Prishtinë, të cilat kanë përfunduar pa ndonjë gjetje, nuk janë të fundit për këtë vit, kanë thënë zyrtarët e Komisionit Qeveritar për Personat e Pagjetur.

Rreth 6 500 persona kanë rezultuar të pagjetur në përfundim të luftës në Kosovë në vitin 1999. Në varrezat masive në Kosovë dhe në Serbi tashmë janë gjetur rreth 70 për qind e tyre. Ndërkaq, fati dhe vendndodhja e rreth 1 600 personave të tjerë nuk dihen ende.



Flet për "Epokën e re", Agim Bahtiri

Mund të shkojmë në zgjedhje, por MPB-në nuk e japim

Anëtari i Këshillit të Përgjithshëm i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Agim Bahtiri, ka bërë me dije se kjo parti në asnjë mënyrë nuk do t'ia japë Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB). Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", kryetari i Mitrovicës ka thënë se LV-ja është e gatshme të shkojë sërish në zgjedhje të reja, por nuk do ta lëshojë këtë ministri. Sipas tij, MPB-ja lidhet me premtimet kryesore të kësaj partie që ka bërë gjatë fushatës zgjedhore për rend dhe ligj. Ai ka deklaruar se MPB-ja është pika kryesore e ndryshimit të gjendjes në Kosovë. Ndërkaq sa i përket postit të presidentit, Bahtiri ka thënë se nuk është koha që të diskutohet për këtë çështje. Ai beson se koalicioni qeverisës në mes të LV-së dhe LDK-së do të arrihet sepse, sipas tij, nuk ka alternativë tjetër

të fituara në mënyrë të paligjshme etj", ka deklaruar Bahtiri.

Madje ai ka bërë me dije se LV-ja është e gatshme të shkojë sërish në zgjedhje për këtë ministri. "Jo, asnjëherë. Ministria e Punëve të Brendshme është ministri që ne nuk ia japim askujt. Ne mund të shkojmë në zgjedhje, por këtë ministri nuk e japim. Nuk e japim sepse dalim para elektoratit tonë të tradhtuar. Pa këtë ministri nuk do të mund t'i realizojmë zotimet që i kemi premtuar", ka deklaruar ai, duke treguar se pse LDK-ja nuk duhet ta udhëheqë këtë ministri. "LDK-ja duhet ta di se më herët i ka pasur tri ministra që kanë drejtuar këtë ministri dhe nuk ka bërë asgjë në këtë

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Anëtari i Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes Vetëvendosje, Agim Bahtiri, njëherësh kryetar i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka treguar se tema krye-

sore që ka bllokuar marrëveshjen për koalicionin qeverisës LV-LDK është Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Ai ka deklaruar se LV-ja nuk lëshon pe për këtë ministri.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bahtiri ka thënë se zotimet që i ka bërë kjo

parti para elektoratit lidhen drejtpërdrejt me këtë ministri. "Mendoj se secili subjekt politik e dëshiron një gjë të tillë, në mënyrë që të jetë komod në qeverisje. Ministria për të cilën po flitet dhe që është temë kryesore është Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Ne nuk

mund ta japim këtë ministri sepse zotimet që i kemi pasur para elektoratit ka qenë edhe kjo ministri, e cila lidhet jashtëzakonisht shumë me temat që jemi zotuar para qytetarëve. Ato janë lufta kundër korrupsionit, forcimi i rendit dhe ligjit, konfiskimi i pasurive



të kryeparlamentarit, të zëvendëskryeministrave, të ministrave dhe të zëvendësministrave. Ne nuk e kemi kërkuar votën që ta menaxhojmë postin e kryetarit të Kosovës. Këtë çështje po e shoh pak të shpejtuar, sepse nuk është koha që posti i presidentit të diskutohet.

"Epoka e re": Nëse LDK-ja heq dorë nga posti i presidenti, do të heqë dorë LV-ja nga Ministria e Punëve të Brendshme?

Bahtiri: Jo, asnjëherë. Ministria e Punëve të Brendshme është ministri që nuk ia japim askujt. Ne mund të shkojmë në zgjedhje, por këtë ministri nuk e japim. Nuk e japim sepse dalim para elektoratit tonë të tradhtuar. Pa këtë ministri nuk do të mund t'i realizojmë zotimet që i kemi premtuar.

"Epoka e re": Pse mendoni se LDK-ja nuk bën ta udhëheqë këtë ministri?

Bahtiri: LDK-ja duhet ta dijë se më herët i ka pasur tre ministra që kanë drejtuar këtë ministri

dhe nuk kanë bërë asgjë në këtë drejtim. Mua më çuditë fakti se pse kjo parti e kërkon këtë ministri kur ka edhe ministri të tjera në të cilat mund ta japë kontributin e vet.

"Epoka e re": Me këto kundërshtime, sa jeni optimist se do të ndodhë koalicioni qeverisës LV-LDK?

Bahtiri: Mendoj se ky koalicion do të lidhet, sepse nuk ka alternativë tjetër. Për këtë jam shumë optimist, sepse s'ka zgjidhje tjetër. Mendoj se secila parti që bojkoton këtë mundësi që të bashkëqeverisim do të pësojë jashtëzakonisht shumë. Unë nuk dëshiroj që LDK-ja të pësojë prej një veprimi të tillë. Dëshiroj që ne të jemi partnerë të sinqertë dhe të punojmë shumë për t'i shtyrë përpara shumë gjëra që janë të nevojshme për Kosovën. Siç dihet, gjendja në Kosovë është keq dhe populli i Kosovës më 6 tetor ka votuar për ndryshim. Ne me njerëz të korrumpuar nuk mund të veprojmë më tutje. Ju e dini se

fillimi i proceseve gjyqësore nis nga Ministria e Punëve të Brendshme, prandaj ne e dëshirojmë këtë ministri.

"Epoka e re": Nëse nuk ndodhë ky koalicion, a keni ndonjë partner tjetër për bashkëqeverisje?

Bahtiri: Mendoj se koalicioni do të ndodhë sepse është në interes të gjithë atyre që na kanë votuar dhe kanë besuar në LV-në dhe LDK-në. Ky koalicion është në interes të Kosovës. Jam i bindur se po të pyetet secili votues i LDK-së, secili do të thotë se kjo ministri duhet t'i jepet LV-së, sepse ne jemi të fuqishëm në këtë drejtim dhe kemi vullnet për forcimin e rendit dhe ligjit. Ne nuk do ta lëshojmë këtë ministri sepse kjo është pika kryesore e ndryshimit të gjendjes në Kosovë. Në këtë mënyrë nuk do të lejojmë që Albin Kurtin ta kemi kryeministër të dështuar. Ne dëshirojmë që bashkërisht me LDK-në ta kemi një qeverisje të suksesshme në mënyrë që të dalim faqebardhë para popullit.

Gjermania në janar dërgon zyrtarët në Kosovë për ta shqyrtuar njohjen e patentshoferëve

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

BLERIN, 5 DHJETOR - Gjermania e përkrah njohjen reciproke të patentshoferëve në mes të Kosovës dhe Gjermanisë. Procesi në fjalë ka shënuar përparim të dukshëm dhe po punohet që me hapa të shpejtë të vijë deri te përmbyllja e këtij procesi. Kështu i ka thënë ambasadorit të Kosovës në Gjermani, Beqë Cufaj, drejtori i Ministrisë së Komunikacionit dhe Çështjeve Digjitale të Qeverisë së Gjermanisë, Guido Zielke.

Ambasadori i Republikës së Kosovës në Republikën Federale të Gjermanisë, Beqë Cufaj, është ftuar më 4 dhjetor në Ministrinë e Komunikacionit dhe Çështjeve Digjitale të Qeverisë së Gjermanisë. Në këtë takim ambasadori Cufaj është prituri nga drejtori i kësaj ministrie, Guido Zielke, me bashkëpunëtorë. Pasi kanë shqyrtuar aspektet e bashkëpunimit mes dy shteteve, pikë kryesore e takimit ka qenë njohja reciproke e patentshoferëve mes dy vendeve pas aplikimit zyrtar që Kosova ka bërë vjeshtën e vitit 2018. "Zielke e ka njoftuar ambasadorin Cufaj që Qeveria e Gjermanisë e përkrah njohjen reciproke të patentshoferëve në mes të Kosovës dhe Gjermanisë. Procesi në fjalë ka

shënuar përparim të dukshëm dhe po punohet që me hapa të shpejtë të vijë deri te përmbyllja e këtij procesi, i cili nga pala gjermane në nivel teknik përmbyllet nga ministria në fjalë dhe ministrat përkatës të 16 republikave gjermane në konferencën e tyre vjetore. Kosova ka shënuar përparim në këtë proces", është bërë me dije në njoftimin e Ambasadës së Kosovës në Gjermani. Zielke e ka njoftuar ambasadorin Cufaj që një delegacion i kësaj ministrie në Kosovë për të parë edhe gjendjen në terren: situatën me qendrat testuese, prodhimin e patentshoferëve, sidomos

shqyrtimin e situatës në aspektin e sigurisë rrugore në Kosovë, pasi që procesi lidhet drejtpërdrejt sidomos me aspektet e sigurisë dhe sidomos me numrin e aksidenteve në rrugët e Kosovës. Ambasadorit Cufaj i është thënë se Qeveria e Gjermanisë është plotësisht e vetëdijshme për nevojën dhe domosdoshmërinë e përmbylljes së këtij procesi. Ambasadori Cufaj ka falënderuar Qeverinë e Gjermanisë për përkrahjen e vazhdueshme dhe i ka siguruar zyrtarët gjermanë që institucionet relevante në Kosovë janë të gatshme ta presin delegacionin gjerman në janar në Kosovë.

drejtim. Mua më çuditë fakti se pse kjo parti e kërkon këtë ministri kur ka edhe ministri të tjera në të cilat mund ta japë kontributin e vet", ka thënë Bahtiri.

Megjithatë, ai ka shprehur optimizëm se, pavarësisht prej këtyre kundërshtimeve, ky koalicion do të arrihet. "Mendoj se ky koalicion do të lidhet, sepse nuk ka alternativë tjetër. Për këtë jam shumë optimist, sepse s'ka zgjedhje tjetër. Mendoj se secila parti që bojkoton këtë mundësi që të bashkëqeverisim do të pësojë jashtëzakonisht shumë", ka thënë Bahtiri.

"Epoka e re": Z. Bahiri, pavarësisht prej pritjeve, ende nuk ka ndodhur nënshkrimi i marrëveshjes për bashkëqeverisje në mes të LV-së dhe PDK-së. Pse?

Bahtiri: LDK-ja dëshiron t'i marrë ministrinë të cilat ajo mendon se janë më të favorshme për të. Mendoj se secili subjekt politik e dëshiron një gjë të tillë, në mënyrë që të jetë komod në qeverisje. Ministria për të cilën po flitet dhe që është temë kryesore është Ministria e Punëve të Brendshme (MPB).

Ne nuk mund ta japim këtë ministri sepse zotimet që i kemi pasur para elektoratit ka qenë edhe kjo ministri, e cila lidhet jashtëzakonisht shumë me temat që jemi zotuar para qytetarëve. Ato janë lufta kundër korrupsionit, forcimi i rendit dhe ligjit, konfiskimi i pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme etj. Pra, këtë ministri ne e kemi numër një, sepse përmes kësaj ministrie do të vendosim rend dhe ligj në Republikën e Kosovës. Me këtë zotim kemi fituar votat e qytetarëve dhe ne nuk mund ta japim këtë ministri.

"Epoka e re": Po ashtu, është thënë se çështja e postit të presidentit është pengesë në nënshkrimin e kësaj marrëveshje?

Bahtiri: Mendoj se në këtë kohë nuk është dashur të bisedohet fare për çështjen e presidentit të ardhshëm. Nuk është koha të bisedohet për këtë temë. Ne kemi një president që ka mandat dhe ai mund të shkarkohet vetëm nëse shkel Kushtetutën e Kosovës. Mendoj se në zgjedhjet e 6 tetorit kemi garuar para qytetarëve për t'i menaxhuar vendet e lira, postin e kryeministrit,



Besimtarët myslimanë në Kosovë mblodhën mbi 300 mijë euro për Shqipërinë

PRISHTINË, 5 DHJETOR (ER) - Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) ka njoftuar se janë mbledhur 304 302 euro për të dëmtuarit nga tërmeti në Shqipëri. Të hollat janë grumbulluar në aksionin e ndër-marrë, sipas deklaratës të myftiut Naim Tërnavë, që në të gjitha xhamitë e Kosovës,

pas namazit të xhumasë të datës 29 nëntor, të mblidheshin ndihma për të prekurit nga tërmeti. "Në ditën kur u ndërmoi ky aksion, që ishte ditë e premte kur imamët mbajnë ligjëratën e rregullt javore në hytbe, imamët janë orientuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame që të flasin

për vlerën e ndihmës - sadakasë, për kuptimet e vëllezërisë kombëtare dhe që ta rikujtojnë xhematin që të lutën e t'i ndihmojnë motrat e vëllezërit nga Shqipëria në të gjitha format e mundshme, përfshirë edhe nëpërmjet aksionit që po ndërmerrej në xhami", ka njoftuar BIK-u.



Dënohet ish-ministri Teodosijeviq që e quajti 'trillim' masakrën e Reçakut

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Ish-ministri i Administratës dhe Vetëqeverisjes Lokale në Qeverinë e Kosovës, Ivan Teodosijeviq, u dënua të enjten në Gjykatën Themelore në Prishtinë me dy vjet burgim. Avokati i tij, Nebojša Vllajiq, ka thënë për "REL" se ky aktgjykim është i padrejtë, i paligjshëm dhe duhet të shfuqizohet. "Është i shkallës së parë dhe jopërfundimtar deri në vendimin e Gjykatës së Apelit", ka thënë Vllajiq. Teodosijeviq u dënua për një deklaratë të bërë në mars, me rastin e 20-vjetorit të bom-

bardimeve të NATO-s në caqet e ish-ushtrisë jugosllave, fushatë kjo që i dha fund luftës në Kosovë. Me atë rast, Teodosijeviq ka thënë se "arsye për agresionin e NATO-s ka qenë e ashtuquajtura katastrofë humanitare në Kosovë dhe masakra e trilluar e Reçakut".

Kryeministri i Kosovës, tashmë në detyrë, Ramush Haradinaj, e shkarkoi Teodosijeviqin rreth dy javë pas deklaratës.

Haradinaj pati thënë se "gjuha e urrejtjes" e një ministri nuk mund të tolerohet.

Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq,



ka thënë se Teodosijeviq u dënua sepse "tha atë që secili serb e di dhe e ndien".

Zyrtarë nga gjykata kanë bërë me

dije se Teodosijeviq nuk ka qenë i pranishëm në seancë dhe se ai është përfaqësuar nga avokati i tij. Sipas rregullave, ekzekutimi i

dënimit me burg pritet të bëhet pasi aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.

Kryetari i Listës Serbe, Goran Rakiq, ka thënë se në rast se aktgjykimi ndaj ish-ministrit Ivan Teodosijeviq bëhet i plotfuqishëm, atëherë do t'i ftojë serbët që të dalin nga institucionet e Kosovës. Sipas tij, thirrja për t'i lënë vendet e punës do t'u bëhet të gjithë përfaqësuesve të pakicës serbe në Kosovë.

Lidhur me dënimin e politikanit serb të Kosovës ka reaguar edhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Ai ka thënë se ky është "vendim i frikshëm" i Prishtinës.

Rast i rrallë, i shpëtohet jeta gruas 39-vjeçare pas shtatzënisë, me çarje aorte

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Një pacientes, me initiale H. B, e moshës 39-vjeçare, i është shpëtuar jeta nga kardiokirurgët në QKUK, e cila, pas lindjes, kishte pësuar çarje-diseksion akut të aortës me prani të flapit intimal, duke filluar nga valvula aortale, me përfshirje edhe të aortës abdominale, duke shkaktuar edhe diseksion të arteries së djathtë të zemrës, respektivisht infarkt akut të murit të poshtëm të zemrës, pamjaftueshmëri të valvulës aortale. QKUK-ja ka bërë me dije se ndryshimet e tjera ishin vërtetuar edhe me CT. "Pacientja ishte transferuar nga emergjenca e Ferizajt në QKUK, me dhimbje të forta në gjoks dhe me shenja në EKG të infarktit akut, të murit të poshtëm të zemrës dhe me nivel të lartë të troponinës. Pacientja ka deklaruar se ka pasur lindje normale katër ditë më parë (dhe kjo ishte lindja e



saj e tretë me radhë). Gjatë këtij intervenimi kirurgjik është bërë Bentall procedurë (ndërrimi i valvulës aortale, rrënjës së aortës dhe zëvendësim i aortës ascen-

dente megraft) dhe bypass - urëzim i arteries së djathtë të zemrës përmes venës në graftin aortal", është thënë në njoftimin e QKUK-së.

Operacioni ka kaluar pa komplikime dhe me menaxhimin e duhur të stafit në mjekimin intensiv kardiokirurgjik dhe Repartin e Kardiokirurgjisë, pacientja është

lëshuar në shtëpi me gjendje të mirë të përgjithshme dhe lokale, për ndjekjen e këshillave të udhëzuara nga klinika në përdorim të terapisë së rregullt.

Disekacioni i aortës haset në tri raste, në 100 000 banorë, është më i shpeshtë te meshkujt sesa te femrat. Faktorë të rrezikut janë hipertensioni, duhanpirja, displipidemia dhe sëmundjet e lindura të indit lidhor. Zakonisht, në shumicën e rasteve paraqitet pas moshës 60-vjeçare, ndërsa në 10 për qind të rasteve para moshës 40-vjeçare. Te femrat e moshës nën 40-vjeçare disekacioni akut i aortës haset në 50 për qind të rasteve gjatë shtatzënisë apo pas lindjes.

Stafi i Klinikës së Kardiokirurgjisë me Kardiologji Invazive u ka bërë me dije të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës që për çdo nevojë, sa iu përket sëmundjeve të zemrës, të drejtohen në QKUK, pa pasur nevojë të kërkojnë ndihmë në qendrat e tjera jashtë.

Sulmohen dy infermierë në spitalin e Mitrovicës

MITROVICË, 5 DHJETOR (ER) - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka pranuar një informatë nga Spitali i Përgjithshëm "Dr. Sami Haxhibeqiri" në Mitrovicë, se të mërkurën, rreth orës 20:00, në Repartin e Emergjencës janë

sulmuar dy infermierë derisa po kryenin punën e tyre. "Infermierët e sulmuar nga familjarët e pacientëve janë: F.M dhe A.H., të cilët kanë marrë lëndime trupore. ShSKUK e dënon dhe cilëson si të papranueshëm sulmin ndaj punëtorëve shëndetë-

sorë, duke kërkuar nga organet kompetente që të merren me rastin në fjalë", është thënë reagimin e ShSKUK-së, duke theksuar se, pavarësisht prej sulmit fizik ndaj infermierëve, pacientët janë trajtuar nga stafi i shërbimit emergjent.



Ligji për paga shkon në Gjykatën Kushtetuese

Avokati i Popullit ka bërë me dije se ka pranuar 35 ankesa nga subjekte të ndryshme të sektorit publik të parashtruara kundër Ligjit për paga në sektorin publik, duke përfshirë këtu ankesat nga të punësuarit në shëndetësi, në arsim, në polici dhe në shërbimin civil. Për këtë arsye, Avokati i Popullit të enjten i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për ta vlerësuar kushtetutshmërinë e Ligjit për paga



EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Avokati i Popullit ka dërguar të enjten në Gjykatën Kushtetuese Ligjin për paga për ta vlerësuar kushtetutshmërinë e këtij ligji. "Avokati i Popullit, në pajtim me autorizimet e tij kushtetuese dhe ligjore, e ka dërguar sot në Gjykatën Kushtetuese Ligjin nr. 06/L-111 për paga në sektorin publik për vlerësimin e përputhshmërisë së tij me Kushtetutën. Në përgjithësi, Avokati i Popullit konsideron se Ligji për paga në sektorin publik dhe Shtojca një (1) e këtij ligji nuk kanë arritur ta bartnin frymën kushtetuese në kuptimin e ndarjes së pushteteve, të barazisë para ligjit dhe as garantimin e së drejtës pronësore. Për më shumë, Avokati i Popullit konsideron se ky ligj nuk është në pajtim me parimet e sundimit të ligjit për shkak të mangësive në kuptimin e qartësisë, saktësisë dhe parashikueshmërisë së tij", është thënë në njoftimin për media të Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit i ka pranuar 35 ankesa nga subjekte të

ndryshme të sektorit publik të parashtruara kundër Ligjit për paga në sektorin publik, duke përfshirë këtu ankesat nga të punësuarit në shëndetësi, në arsim, në polici dhe në shërbimin civil. "Avokati i Popullit ka kërkuar edhe vendosjen e masës së përkohshme ndaj zbatimit të Ligjit për Paga në Sektorin Publik deri në një vendim përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese, duke vlerësuar se vendosja e masës së përkohshme është e nevojshme për ta mbrojtur interesin publik dhe për t'i evituar dëmet e pariparueshme që do të mund të shkaktoheshin me zbatimin e këtij ligji. Duke marrë parasysh faktin se ka një numër të madh ankesash nga subjekte të ndryshme të sektorit publik, Avokati i Popullit konsideron se ekziston interesi publik që pajtueshmëria e këtij ligji me Kushtetutën të vlerësohet nga Gjykata Kushtetuese. Avokati i Popullit mbetet i përkushtuar që në mënyrë të pavarur t'i adresojë shqetësimet e qytetarëve të Republikës së Kosovës në funksion të ushtrimit të detyrave të veta të përcaktuara me

Kushtetutë dhe me ligj", është bërë me dije në këtë njoftim.

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës së Kosovës (SBASHK), Rahman Jasharaj, ka thënë se nëse nuk do të zbatohet Ligji për paga nga ky muaj mund të ketë reagime dhe veprime nga kjo sindikatë.

Jasharaj ka bërë me dije për "Epokën e re" se për këtë çështje e kanë njoftuar edhe Avokatin e Popullit. "Në takim me Avokatin e Popullit isha bashkë me kryetarin e Sindikatës së Shëndetësisë, Blerim Sylja dhe me kryetaren e Sindikatës së Policisë, Valbona Kamberi. E kemi informuar Avokatin e Popullit lidhur me situatën që është krijuar mes anëtarësisë së këtyre tri sindikatave pasi është thënë dhe është dëgjuar se ai, mbase, do ta dërgojë Ligjin e Pagave në Kushtetuese. SBASHK-u fillimisht kishte bërë angazhime të shumta që Projektligji për paga të tërhiqej dhe të uleshin të gjitha palët e ta

përgatitnin si duhet sepse, e kemi thënë shumë herë dhe publikisht, se Projektligji ishte i dobët dhe, për sistemin arsimor, degradues dhe nënçmues. Por, kjo nuk u bë dhe u desh të bëjmë shumë angazhime të tjera, pastaj edhe grevë, për t'i ndryshuar koeficientet. Njerëzit kanë qenë në pritje që Ligji për Paga të nisë të zbatohet me pagën e dhjetorit dhe ia kemi thënë Avokatit të Popullit se nëse kjo nuk ndodh atëherë mund të ketë reagime dhe veprime", ka thënë Jasharaj. Në këtë kontekst, Jasharaj ka thënë se do ta respektojë zërin e punëtorëve të arsimit. "Unë, si gjithmonë, do ta respektoj zërin e punëtorëve të tërë sektorit të arsimit. Do të veproj ashtu si kërkojnë ata dhe ashtu si vendos Këshilli Drejtues i SBASHK-ut, në të cilin janë përfaqësuesit e tërë sektorit të arsimit, nga çerdhet, arsimit parauniversitar dhe universitetet", është shprehur Jasharaj.

Edhe bordi drejtues i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të

Kosovës të mërkurën ka mbajtur një takim me bordin drejtues të drejtorëve të institucioneve shëndetësore që janë në varësi të ShSKUK-së, Federatën Sindikale të Shëndetësisë dhe Odën e Mjekëve të Kosovës, ku temë diskutimi ishte zbatimi i ligjit të ri për paga. Qëndrim i përbashkët i të pranishmëve ishte se ky ligj është i mirëseardhur për të gjithë profesionistët shëndetësorë dhe se presin që në fund të këtij muaji punëtorët shëndetësorë t'i marrin pagat me rritje.

Në takim u tha se tendencat për ta pezulluar zbatimin e këtij ligji janë të papranueshme dhe kanë për qëllim ta dëmtojnë përparimin e arritur në drejtim të përmirësimit të përgjithshëm të mirëqenies së punëtorëve shëndetësorë.

Institucionet e pranishme në takim u kanë bërë thirrje të gjitha institucioneve vendimmarrëse të jenë të kujdesshme dhe mos ta pengojnë zbatimin e këtij ligji për interesa të grupeve të ndryshme.

Rreth 100 mijë vaksina kundër gripit arrijnë sot në Kosovë

Sot (e premte) do të arrijnë në Kosovë rreth 100 000 vaksina kundër gripit, ndërsa shpërndarja e tyre do të fillojë javën tjetër. Vaksinat kundër gripit sezonal, të cilat do të përdoren sivjet, sipas rekomandimeve të bëra nga OBSH-ja, do të jenë katër shtamëshe, që e rrisin fuqinë mbrojtëse ndaj viruseve më agresive në qarkullim të gripit sezonal

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike kanë informuar qytetarët se në funksion të parandalimit të gripit sezonal, MSh-ja i ka porositur rreth 100 000 vaksina kundër gripit (prej tyre 500 doza pediatrike), të

cilat janë porositur përmes shërbimeve të prokurimit të UNICEF-it.

Vaksinat e porositura pritet të arrijnë në Kosovë ditën e premte (6 dhjetor), ndërsa shpërndarja e tyre do të fillojë javën tjetër. Vaksinat kundër gripit sezonal, të cilat do të përdoren sivjet, sipas rekomandimeve të bëra nga OBSH-ja, do të jenë katër



shtamëshe, që e rrisin fuqinë mbrojtëse ndaj viruseve më agresive në qarkullim të gripit sezonal.

Duke pasur parasysh se vaksi-

nat kundër gripit sezonal, të cilat sivjet do të përdoren për herë të parë janë katër shtamëshe, disa vonesa janë regjistruar si në Kosovë ashtu

edhe në vendet e rajonit. Vaksinat janë të dedikuara për t'i mbrojtur grupet më të ndjeshme të popullatës, si të moshuarit dhe të prekurit nga sëmundjet kronike.

Vaksinat e siguruar përmes UNICEF-it janë të parakualifikuara sipas standardeve të OBSH-së dhe garantojnë cilësinë dhe sigurinë e tyre. Këto vaksina të blera nga MSh-ja, që kanë kushtuar 444.170 euro, do t'i shpërndahen popullatës përmes IKSHKP-së dhe Njërive të vaksinimit në QKMF-të e Kosovës.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i siguron qytetarët se po e monitoron me kujdes situatën epidemiologjike në vend dhe ka rritur vigjilencën për t'u përballur me raste eventuale të gripit sezonal.

Çmimet e importit u ngritën për 2.1 për qind

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), në tremujorin e tretë të vitit 2019, krahasuar me TM2 2018, çmimet e importit u ngritën në një mesatare prej 2.1 përqindësh

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇIMP) për periudhën tremujore TM3 2019. Sipas ASK-së, indeksi i tërësishëm i çmimeve të importit në Kosovë pësoi rënie për (-0.9 për qind) në TM3 2019 krahasuar me TM2 2019.

"Rënie më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve ishin te: lëkura dhe artikujt e saj (-10.1 për qind); prodhimet minerale (-4.0 për qind); tekstili dhe artikujt e tij (-3.4 për qind); plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (-2.0 për qind); instrumentet optike, fotografike, matëse, mjekësore dhe muzikore, si dhe mekanizmat e orës (-2.0 për qind); mjetet e transportit (-0.9 për qind); pajisjet e makinerisë

dhe pajisjet elektrike (-0.7 për qind); druri dhe artikujt e tij (-0.3 për qind); prodhimet e industrive kimike (-0.3 për qind); vajrat ushqyese (-0.3 për qind); metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-0.2 për qind); dhe artikujt e ndryshëm të prodhuar (-0.2 për qind)", është thënë në raportin e ASK-së, duke shtuar se rënia u neutralizua kryesisht nga ngritja e çmimeve sipas sektorëve te: prodhimet bimore (2.9 për qind); shtazët e gjalla dhe prodhimet e tyre (0.5 për qind); këpucët (0.4 për qind); dhe artikujt e gurit, llaçit, prodhimet e qeramikës dhe të qelqit (0.1 për qind). "Ndërkaq, krahasuar me TM2 2018 çmimet e importit u ngritën në një mesatare prej 2.1 përqindësh. Ngritje më të mëdha, sipas sektorëve, ishin te: prodhimet bimore (22.4 për qind); shtazët e gjalla dhe prod-



himet e tyre (11.5 për qind); lëkura dhe artikujt e saj (11.1 për qind); prodhimet minerale (8.3 për qind); artikujt e ndryshëm të prodhuar (6.7 për qind); artikujt e gurit, llaçit, prodhimet e qeramikës dhe të qelqit (1.6 për qind); këpucët (1.1 për qind); metalet bazë dhe artikujt e tyre (1.0 për qind); letrat dhe artikujt e saj (0.5 për qind); prodhimet e industrive kimike (0.4 për qind); dhe plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (0.2 për qind)", është thënë në raportin e ASK-së.

Sipas këtij raporti, ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve te: instrumentet optike, fotografike, matëse, mjekësore dhe muzikore, si dhe mekanizmat e orës (-16.4 për qind); tekstili dhe artikujt e tij (-12.4 për qind); pajisjet e makinerisë dhe

pajisjet elektrike (-2.4 për qind); vajrat ushqyese (-1.8 për qind); artikujt ushqimorë të përgatitur,

pijet dhe duhani (-0.1 për qind); dhe druri dhe artikujt e tij (-0.1 për qind).

Prishtina me numrin më të madh të vizitorëve

Po ashtu, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Statistikat e Hotelierisë në Kosovë për periudhën TM3 2019. Në tremujorin e tretë të vitit 2019 (TM3 2019) pjesë e anketës ishin 216 hotele të cilat ushtrojnë veprimtari hoteliere në territorin e Kosovës.

Pjesa më e madhe e hoteleve gjenden në rajonin e Prishtinës, Pejës e kështu me radhë. "Në TM3 2019 numri i vizitorëve (vëndorë dhe të huaj) ishte 86 075, prej tyre

37.28 përqindësh ishin vëndorë dhe 62.72 për qind ishin të huaj. Ndërsa numri i netqëndrimeve ishte 155 784 net, prej tyre 31.78 për qind nga vëndorët dhe 68.22 për qind nga të huajt. Numrin më të madh të vizitorëve dhe netqëndrimeve të tyre e ka rajoni i Prishtinës me 35 268 vizitorë dhe 63 037 netqëndrime", është thënë në raportin e ASK-së, duke theksuar se numri më i madh i vizitorëve të huaj vijnë nga Shqipëria, Gjermania, Zvicra etj.



Shahini: Falë taksës 100 për qind bizneset vendore janë shumë më mirë këtë vit

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) dhe rrjeti i marketeve "Viva Fresh Store" kanë organizuar hapjen e ekspozimit dhe promovimit të prodhimeve vëndëse në kuadër të "Javëve të Biznesit Kosovar 2019", me moton "Unë konsumoj produkte vëndore, po ju?" Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka thënë se këtë vit prodhimet vëndore janë më të mira se në vitin e kaluar falë taksës 100 për qind. "Nga viti në vit kemi kaluar shumë kilometra e shumë qytete për ta ndërruar mentalitetin konsumues dhe kjo ka bërë që kudo që shkojmë, fjala konsum i prodhimeve vëndore tash është bërë mik i të gjithë qytetarëve të Kosovës. Këtë vit jemi shumë mirë falë taksës



100 për qind, e cila mbështeti drejtpërdrejt prodhimet vëndore falë shumë iniciativave të marra nga AKB-ja dhe insti-

tucionet e shtetit në të mirë të ekonomisë dhe prodhimit të vëndit. Sot kemi shumë prodhues të vëndit për të cilat ne

mburremi. Këta prodhues kanë krijuar brend, janë në Kosovë dhe përtej oqeanit", ka thënë Shahini. Ai ka thënë

se motoja "Unë konsumoj produkte vëndore, po ju?", do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Liridon Berisha, drejtor i marketingut në "Viva Fresh", ka thënë se raftet në "Viva Fresh" janë mbushur me prodhime vëndore. "Ky nuk është event i fundit, pasi vitin e ardhshëm do të bëjmë edhe më shumë për këtë event. Unë jam i lumtur që raftet tona po mbushen me prodhime vëndore. Si kompani u kemi dhënë rëndësi të rëndësishme prodhimeve vëndore. Çdo vit kemi rritje të shitjeve të prodhimeve vëndore dhe jemi duke i përkrahur maksimalisht në mënyrë që t'i tejkalojmë ose t'i zëvendësojmë produktet e importit", ka thënë Berisha.

Kosova mund ta nisë vitin 2020 pa buxhet



PRISHTINË, 5 DHJETOR - Vonesat e krijuara me procesin zgjedhor dhe, së fundit, me arritjen e marrëveshjes për koalicionin qeverisës, mund të ndikojnë që Kosova të hyjë në vitin 2020 pa buxhetin e miratuar. Qeveria në detyrë ka miratuar vetëm kornizat buxhetore, por ajo nuk mund ta miratojë projektligjin, pasi që Kuvendi është i shpërndarë dhe nuk ka kush ta miratojë atë në formë ligji. Deri më tani është e miratuar vetëm korniza afatmesme e shpenzimeve 2020 - 2030. Korniza afatmesme e shpenzimeve paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të duhej të hartohet buxheti vjetor për vitin 2020. Buxheti i Kosovës për vitin 2020, sipas kornizës afatmesme, parashihet të jetë

rreth 2.4 miliardë euro apo një milion euro më shumë sesa buxheti i këtij viti. Lulzim Rafuna, këshilltar i ministrit në detyrë të Financave në Qeverinë e Kosovës, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se mosmiratimi i buxhetit deri në shkurt të vitit të ardhshëm nuk paraqet ndonjë problem të theksuar. Sipas tij, problemet fillojnë pas muajit shkurt, nëse deri atëherë nuk konstituohet Kuvendi i ri i Kosovës. "Për muajt janar - shkurt nuk do të ketë asnjë problem, kurse për muajt mars shpresojmë që deri atëherë ta kemi Kuvendin e Kosovës. Nëse konstituohet Kuvendi, atëherë me një vendim mundet që edhe muaji mars të mbulohet me shpenzime buxhetore, por sfidat dhe

problemet do të paraqiteshin në muajt prill, pasi që (në atë muaj) më asnjë pagesë e brendshme nuk do të mund të bëhet përveç borxhit ndërkombëtar që e kemi", ka thënë Rafuna. Po të mos ishte vit zgjedhor, kur edhe pritet të konstituohen institucionet e reja, në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike, deri më 31 tetor Qeveria e Kosovës do të duhej ta miratonte buxhetin e propozuar dhe ta dërgonte atë në kuvend. Afati i fundit kur Kuvendi miraton buxhetin e Kosovës është 31 dhjetori. Nëse buxheti nuk është miratuar deri më 31 dhjetor atëherë, në bazë të procedurave ligjore, Kuvendi me anë të një vendimi mund ta autorizojë vazhdimin e zbatimit të

Ligjit për ndarjet buxhetore të vitit të kaluar fiskal. Ligji për ndarjet buxhetore i vitit të kaluar fiskal në asnjë rast nuk mund të vazhdojë të zbatohet më gjatë se tre muajt të vitit të ardhshëm fiskal. Flamur Keqa, ekspert për çështje financiare, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" thotë se vonesat në miratimin e një buxheti nuk janë të shëndetshme për ekonominë e një shteti. "Mosmiratimi i buxhetit për vitin 2020 paraqet një problematikë në vete, në kushte normale, në veçanti në kushtet kur kemi ndërrimin e koalicionit qeveritar, do të thotë qeverisjen do ta marrin dy parti të reja politike të cilat e kanë programin e vet qeverisës, program që nuk është bërë

ende transparent në publik dhe kjo ndikon që mosmiratimi i buxhetit për vitin 2020 është me pasojë për ekonominë dhe zhvillimin normal të institucioneve shtetërore që prekin edhe operatorët ekonomikë, qofshin publikë apo privatë", ka thënë Keqa.

Kosova edhe në vitin 2019 pati hyrë pa buxhetin e miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Buxheti për vitin 2019 në vlerë prej 2.3 miliardë eurosh ishte miratuar në muajt shkurt.

Përfaqësuesit e partive që i kanë fituar zgjedhjet e 6 tetorit, nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, patën thënë për "Radion Evropa e Lirë" se projeksionet e buxhetit për vitin 2020, sipas kornizës afatmesme të shpenzimeve të bëra nga Qeveria në largim të Kosovës, do të rishikohen.

Eksperti i ekonomisë, Keqa, thotë se qeveria e re do të duhet të bëjë një projektim më të mirë të buxhetit. "Qeveria e re besoj se do të ketë ndryshime sa i përket strukturës së buxhetit. Konsideroj se është e arsyeshme që qeveria e re ta përkrahë ekonominë dhe arsimin, në këtë drejtim buxheti i ri do të jetë me strukturë të re. Kjo qeveri do ta bëjë ndryshimin e strukturës në kategori të ndryshme buxhetore", ka thënë Keqa.

Infrastruktura rrugore kryesisht ka mbizotëruar investimet në Kosovë vitet e fundit. Përveç autostradave, investime të mëdha janë përqendruar edhe në ndërtimin e rrugëve lokale dhe magjistrale. Përqindja më e madhe e buxhetit të Kosovës zakonisht është ndarë pikërisht për ndërtimin e autostradave. Organizatat ekonomike në Kosovë në vazhdimësi kanë hedhur kritika për projektimin e buxhetit ndër vite. Qeveria në largim ishte kritikuar edhe për mungesë të kulturës së menaxhimit të mjeteve buxhetore.

Ministrja Zhiviq në Panairin Ndërkombëtar të Bujqësisë "CroAGRO" në Zagreb

ZAGREB, 5 DHJETOR (ER) - Një delegacion i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, i udhëhequr nga ministrja në detyrë, Dijana Zhiviq, po merr pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Bujqësisë, Pajisjeve dhe Makinerisë Bujqësore "CroAGRO", i cili po mbahet në Zagreb të Kroacisë.

Në këtë panair po marrin pjesë kompani nga vende të ndryshme të botës, të cilat gjatë ditëve sa do të zgjasë panairi do t'i prezantojnë pajisjet dhe makineritë bujqësore. Të enjten ministrja në detyrë e MBPZHR-së, Dijana Zhiviq, është takuar me ministren e Bujqësisë të Kroacisë, Marija Vuckoviq, me të cilin

kanë biseduar lidhur me mundësitë e bashkëpunimit në sektorin e bujqësisë në mes të Republikës së Kosovës dhe asaj të Kroacisë. Panairi Ndërkombëtar i Bujqësisë, Pajisjeve dhe Makinerisë Bujqësore "CroAGRO" është hapur të enjten dhe do të zgjasë deri më 8 dhjetor.



Koordinatori Hoti: Kur ekziston vullneti për të punuar nuk mungon sukcesi

DRENAS, FUSHË-KOSOVË, 5 DHJETOR (ER) - Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Kosovës, Rexhep Hoti, është takuar me drejtorët e shkollave të Komunës së Drenasit dhe të Fushë-Kosovës. Ata kanë diskutuar për Programin Nacional për Rininë dhe për garat që janë duke u zhvilluar në kuadër të këtij programi. Koordinator Hoti i ka përgëzuar drejtorët e shkollave të Drenasit për suksesin e nxënësve në garën nacionale të kreativitetit kulturor dhe mendimit kritik dhe atyre të diturisë. Ai ka thënë se ky sukses nuk do të ishte i mundur pa përkushtimin e drejtorëve komunalë të arsimit, drejtorëve dhe stafit të shkollave. "Brenda një viti në bashkëpunim me ju arritëm të shpallim gjithsej 44 723 fitues në

të dyja garat, në të tre nivelet. Vetëm Komuna e Drenasit ka gjithsej 2 336 fitues në garën e kreativitetit kulturor dhe mendimit kritik dhe në garën e diturisë, e për këtë sukses meritat i keni ju të gjithë. Ne së bashku kemi dëshmuar se kur ekziston vullneti dhe dëshira për të punuar, nuk mungon sukcesi", ka thënë Hoti. Ndërsa nënkryetari i Komunës së Drenasit, Nazmi Hasi, i cili aktualisht ka edhe kompetencat e drejtorit të Arsimit në këtë komunë, e ka falënderuar koordinatoren Hoti për takimin dhe ka thënë se Programi Nacional për Rininë do të ngritë cilësinë e arsimit. "Dua ta falënderoj koordinatoren Hoti për programin dhe për vizitën në komunën tonë. Programi Nacional për Rininë është një



program i qëlluar dhe në të ardhmen do të ndikojë edhe në përmirësimin e rezultateve të PISA-s. Komuna jonë ka pasur rezultate të mira në të gjitha nivelet, kemi pasur fitues edhe në nivelin republikan, prandaj duhet të përkushtohemi që edhe në garat e tanishme të tregojmë sukses. Ky program është krah i

djathhtë i ngritjes së cilësisë së arsimit", është shprehur Hasi. Pjesëmarrëse në këtë takim ishte edhe drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Shqipe Zogu, e cila ka thënë se drejtorja që ajo drejton është e përkushtuar që procesi i garave të sportit të ecë mbarë. Koordinator Hoti ka takuar edhe drejtorët e shkollave të Komunës

së Fushë-Kosovës me të cilët ka biseduar për ecurinë e garave dhe për suksesin e nxënësve në këtë komunë.

Në shenjë falënderimi për bashkëpunimin dhe për rezultatet, koordinatori Hoti ka ndarë mirënjohje për DKA-të e të dyja komunave si dhe për drejtorët e shkollave të tyre.

Përmbillet kampanja 'Ruje mos e gjuj', riciklohen mbi 40 tonë plastikë

VUSHTRRI, 5 DHJETOR (ER) - Green Art Center-Prishtina (GAC), në kuadër të kampanjës "Ruje mos e gjuj", kampanjë kjo që u financua prej Coca Cola HBC dhe u implementua në partneritet me MMPH-në, Komunën e Vushtrrisë dhe disa institucione publike dhe private në Kosovë, shihet të jetë treguar e suksesshme, pasi është raportuar se janë mbledhur mbi 40 tonë mbeturina të riciklueshme (plastikë dhe alumin) gjatë kësaj periudhe nëntëmuajore të implementimit të ndarjes së mbeturinave të riciklueshme vetëm në disa institucione universitare private në Prishtinë dhe në 500 amviseri në Vushtri.



Zyrtarët e GAC-it raportojnë se kjo kampanjë është mirëpritur nga qytetarët në zonat dhe institucionet ku është zhvilluar

dhe gatishmëria e tyre për t'i ndarë mbeturinat e riciklueshme në burim e tregon suksesin e saj. Kampanja "Ruje mos e gjuj" iu bashkëngjiti aktiviteteve të Green Art Center (GAC), duke iu kontribuar projekteve që GAC-i implementon në shtrirjen e skemës së riciklimit të mbeturinave në komunitet dhe ku shihet si domosdoshmëri që prodhuesit e ambalazheve ta marrin përgjegjësinë e tyre për ndotjen në mjedis që shkaktojnë prej mbetjeve të ambalazhimit.

Bahtiri takohet me afaristë nga Turqia për investime milionëshe në Mitrovicë

MITROVICË, 5 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, së bashku me nënkryetarin Faruk Mujka, kanë pritur në një takim përfaqësues të lartë nga kompania e energjisë elektrike në Turqi "Euro Holding", në krye me Tamer Pektas, me të cilët ka biseduar për mundësitë e bashkëpunimit dhe investimeve në qytetin e Mitrovicës.

Kryetari Bahtiri i ka falënderuar të pranishmit për interesimin e tyre për të investuar në qytetin e Mitrovicës dhe më pas ata i ka njoftuar me kushtet që Komuna e Mitrovicës ofron për investitorët e huaj. Në fjalën e tij përfaqësuesi nga kompania "Euro Holding", Pektas, ka njoftuar lidhur me projektin energjik të cilin parashihet ta realizojnë ata në qytetin e Mitrovicës, përmes grumbullimit dhe riciklimit të mbeturinave duke prodhuar energji elektrike. Ky projekt parasheh riciklimin e



mbeturinave me kapacitet deri në 120 tonë në ditë, duke përpunuar të gjitha llojet e mbeturinave, me përjashtim ato të cilat kanë radioaktivitet duke mos liruaz gazra dhe për ta ruajtur mjedisin. Me këtë rast, kryetari Agim Bahtiri ka bërë me dije se Komuna e Mitrovicës ofron kushte dhe lehtësira shumë të mëdha për të gjithë ata që synojnë të investojnë në projekte të ndryshme, duke përmendur dhënie të tokës falas, pastaj edhe lehtësirat e tjera procedurale.

Po ashtu, kryetari Bahtiri ka theksuar se ky investim do të jetë shtytje e zhvillimit ekonomik pasi përmes kësaj fabrike nuk do të ketë më ndotje as për punëtorët e as për mjedisin dhe rrethinën.

Përurohët Qendra e Mjekësisë Familjare në Neredime

FERIZAJ, 5 DHJETOR (ER) - Banorët e fshatrave të zonës së Jezercitani e tutje do t'i kenë më afër shërbimet mjekësore falë Qendrës së re të Mjekësisë Familjare e cila është inauguruar të enjten, me ç'rast është thënë se i kontribuon konceptit sa më afër qytetarëve që është edhe bazë e mjekësisë familjare. Në përuarimin e kësaj qendre ka marrë pjesë kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, i shoqëruar nga drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Bekim Ademi, drejtoresha e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, Nadire Imeri, si dhe zyrtarë të tjerë. Me këtë rast, drejtues të



shëndetësisë ferizajase, të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, mjekë dhe qytetarë kanë folur për këtë projekt si i domosdoshëm për banorët e kësaj ane. Haki Kashtanjeva nga Neredimja është një ndër të shumtët që do të kërkojë shërbime në këtë qendër. Ai ka thënë se tashmë e kanë më të lehtë qasjen në shërbimet mjekësore, duke falënderuar përkushtimin e institucioneve dhe të kryetarit Agim Aliu për orientimin e drejtë të këtij projekti.

Por, ai ka pasur edhe një kërkesë që kjo qendër t'i plotësojë me shërbime të gjitha nevojat e

qytetarëve të kësaj ane. Në anën tjetër, drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë, Bekim Ademi, ka thënë se kjo do të jetë një qendër funksionale nga fakti se po synohet që, përpun mjekut dhe infermierëve, në kuadër të kësaj qendre të jenë edhe njësitë e tjera, si stomatologjia, laboratorit e barnatorja. Ngritja e kësaj qendre ka kushtuar 130 mijë euro, fonde këto që janë siguruar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komuna e Ferizajt. Në këtë qendër shërbime do të marrin banorët e fshatrave Manastirc, Balaj, dy Nerodimeve dhe të fshatit Jezerc.

Shqetësuese renditja e Kosovës në PISA 2018?, por janë dy gjëra edhe më shqetësuese në arsimin e Kosovës

(Rezultati i PISA-s, sa i përket Kosovës, nuk ka nevojë për analizë të hollë. Mjafton një e "trashë" dhe shihet, jo vetëm shkaku i rezultatit, por edhe diçka më thellë.)



Shkruan: Shukri KLINAKU

Pas publikimit të vlerësimit ndërkombëtar PISA 2018 shoh shqetësim të ligjshëm në publik për renditjen e Kosovës në këtë vlerësim. Megjithatë, unë shqetësohem për faktin se ky shqetësim i publikut, e aq më keq shqetësimi i institucioneve, nuk është i adresuar si duhet. Me fjalë të tjera, konsideroj se ne nuk duhet të shqetësohemi dhe të vajtojmë për renditjen jo të kënaqshme të Kosovës në PISA 2018 sepse në një garë dikush duhet të renditet i fundit madje, po të jetë gara e fortë, edhe i fundit mund të ketë vlera të çmueshme. Ne duhet të shqetësohemi për dy gjëra të tjera, të cilat, sado që në dukje të parë pasqyrohen në renditjen e PISA-s 2018, sipas bindjes sime, pasqyrimi i tyre

është shumë i zbehtë. Konkretisht nga renditja e Kosovës në rezultatin e PISA-s nuk del qartë: (1) huqi i madh i MASHT-it lidhur me kuptimin e testit PISA; (2) nuk del qartë, as për së afërmi, shkalla e ulët e organizimit të arsimit në Kosovë.

Shqetësimi i parë: MASHT-i nuk e di rolin e vet në raport me testin PISA

MASHT-i krenohet dhe krenohet se ka përgatitur nxënësit me "program të posaçëm" për testin PISA 2018. Ka veshur hyrjen e ndërtesës së MASHT-it me pllakate ku shkruan: PISA 2018 po vjen! Ky është huqi i madh MASHT-it. MASHT-i nuk e ka kuptuar se për PISA dhe për të gjitha testet e tjera duhet t'i kryejë detyrat për çdo ditë dhe të të gjitha fronteve për çka ngarkohet. MASHT-i në raport me testin PISA luan rolin e studentit kalkulues; studentit që kalkulon se çka të mësojë e çka të mos mësojë për provimin që e pret. Pra, MASHT-i, në vend se t'i kryejë të gjitha detyrat që i ngarkohen dhe ta presë rezultatin, kalkulon se në cilën pjesë ta

sforcojë punën në mënyrë që rezultatin në PISA ta marrë të mirë. Ky është huqi i madh. Dhe ky huqi u ngarkohet (me organogram) vetëm dy personave në Kosovë, kryeministrit dhe ministrit të MASHT-it.

Shqetësimi i dytë, kryesori: Shkalla e organizimit të arsimit në Kosovë

Organizimi i arsimit në Kosovë vuan prej disa mungesave dhe sëmundjeve të mëdha. E para, Kosova ende nuk ka pasur kryeministër me vizion për arsimin e vendit. Pra, gjithnjë vizioni për arsimin e Kosovës i ka mbetur barrë vetëm ministrit të arsimit. E dyta, edhe më keq, Kosova ende nuk ka pasur ministër të arsimit që ka pasur vizion për arsimin e Kosovës. Për shkak të këtyre dy mungesave të mëdha në këto 20 vjet na ka përcjellë një paradoks. Deri më tani Ministria e Arsimit, në radhë të parë, nuk i ka shërbyer organizimit të arsimit! MASHT-i deri më sot ka pasur agjendat partiake, grupe dhe personale. E treta, ato që vërehen dhe që dëmtojnë drejtpërdrejt më së shumti - sëmundjet e organizimit të arsimit tonë. "Ekspertët" e arsimit janë të prirë të na thonë se arsimi në Kosovë vuan për shkak të mosrealizimit të disa metodave e të disa proceseve me terme sub-speciale, të cilat nuk

i deshifron dot asnjëri nga ministri e arsimit të pasluftës, asnjëri nga rektorët, madje asnjëri prej dekanëve të fakulteteve të edukimit që ka Kosova. Jo të nderuar "ekspertë", sëmundjet e arsimit në Kosovë janë më të thjeshta, më të rënda, që shihen më lehtë se ato sëmundjet "speciale". Sipas bindjes sime, sëmundjet kryesore në arsimin tonë janë: pozitat udhëheqëse në institucionet arsimore zihen me korrupsion, bërryla ose me muskuj (prej ministrit, rektorëve, dekanëve e më poshtë); pastaj këta realizojnë misionin e tyre. Prandaj, sot institucionet arsimore më shumë ngjajnë në çerdhe partiake dhe në skema sociale (bamirësie). Duke qenë se këta udhëheqës me muskuj apo të korrumpuar nuk kanë vizion për institucionin që udhëheqin (sepse as që u kërkohet), më së shumti merren me arkën e institucionit. E arkën, dihet si e ndajnë. Në ndarje të arkës nuk është më e keqja se ndajnë më së shumti për xhepin e vet, por se iu ndajnë shumë edhe njerëzve të tjerë përreth me muskuj (atyre që zakonisht janë për ndëshkim, e jo për shpërblim), në mënyrë që ta blejnë mandatin vijues. Në këto rrethana arsimin në Kosovë e mbajnë një grusht i punëtorëve idealistë dhe një shumicë e punëtorëve të arsimit që punojnë me vegim; pra, jo orga-

nizimi shtetëror nga ana e MASHT-it. Prandaj, çdo tentim për analizë të hollë të rezultatit të Kosovës në PISA 2018 është gabim, sepse analiza do të ishte largim nga objektivi ku do të duhej të përquedrohej një qeveri arsimdashëse në të ardhmen. Me fjalë të tjera, testi PISA është i ndërtuar për të vlerësuar sisteme funksionale (normale) të arsimit, e jo si ky i yni.

Çka duhet të bëjë ministri i ri i MASHT-it?

Nëse është njohës i arsimit dhe nëse është i përkushtuar për arsim dhe vetëm për arsim, ministri i ardhshëm: së pari, vendos rregulla rigorozë për bartësit e pozitave udhëheqëse në arsim; së dyti, vendos standard të lartë në zbatimin e ligjit, statuteve dhe rregulloreve; së treti, cakton 3-4 prioritetet për mandatin e vet, e ku njëri prej prioritetëve duhet të ishte politika radikale në forcimin e fakulteteve të edukimit. Sot fakultet e edukimit (fabrikat e mësimdhënësve parauniversitarë) janë më të dobëta në universitetet tona, kanë udhëheqjet më të dobëta, kanë kryesisht mësimdhënësit më të dobët dhe rekrutojnë kryesisht studentët më të dobët.

Pas 2-3 vjet pune me këto premisa u vjen radha edhe analizave të holla për arsimin, me terma speciale për arsimin.

Shitja, aftësi e domosdoshme në çdo profesion



Shkruan: Gentrit KADROLLI

Po qe se bëjmë një krahasim të fuqisë së klientit në të kaluarën me kohën e sotme, shohim se është bërë përparim i madh falë disa faktorëve, në veçanti atij teknologjik, i cili ka ndryshuar metodat se si klientët e përdorin fuqinë e tyre.

Sa herë që flasim për fuqinë/pushtetin që e ka një klient kundrejt kompanisë duhet të kthehemi në histori dhe të kujtojmë disa raste të kompanive gjigante (Lamborghini & Ferrari), kur mosdëgjimi i klientit apo mospërfillja e keshillave të klientëve doemos që ka për ta bërë një kompani të ndryshojë në atë se çfarë bën në raport me klientin apo në fund ka për të dështuar. Personalisht, shumë vite më parë, kur kam filluar të merrem me shitje, kisha filluar pa ndonjë arsye, por që sot e konsideroj veten me fat për

arsye se shitja sot është bërë aftësi e domosdoshme e çdo profesioni tjetër qoftë në arkitekturë, marketing, dizajn grafik dhe profesione të tjera sepse të gjithë ata që merren me këto punë kanë nevojë që një ide apo punë të pëlqehet nga klientët e tyre.

Shitja, profesion që nuk bëhet monoton

Të shesësh një send duhet të kesh disa aftësi. Po nuk i pati, s'mund të kesh sukses. Prandaj shohim që disa dorëzohen shpejt e disa vazhdojnë më tutje. Ata që nuk dorëzohen e kanë kuptuar mirë që edhe një klient i vetëm nuk ka qëndrueshmëri në vendimet e tij që i merr. Për shembull, nëse në këtë javë nuk ka disponim çfarëdo që t'i ofrohet, mundësia është e madhe që përgjigja e tij të jetë jo, që në asnjë mënyrë nuk duhet ta marrim si personale dhe si një jo vendimtare sepse ne nuk e dimë në çka ka kaluar ai klient, as gjendjen emocionale të tij. I njëjti në javën tjetër mund të jetë krejtësisht ndryshe. Dhe nëse shitësi është i përgatitur, shitja mund të ndodhë më shpejt sesa që ka planifikuar të ndodhë.

Roli, shërbimi cilësor në shitje

Në ditët e sotme shërbimi cilësor i stafit jo vetëm shitës, por i tërë kompanisë e ka peshën më të madhe. Hulimtimet bërë kohën e fundit na tregojnë se shërbimi jociësor zë vend në përqindjen më të madhe përse klientët e ndërpresin apo nuk vazhdojnë bashkëpunimin me një kompani, kurse përqindja e atyre të cilët ankohen në kompani apo e atyre që vazhdojnë prapë të shërbehen lë shumë për të dëshiruar.

Pse ndodh kjo?

Shpesh ndodh kur shitësi nuk e merr trajnimin e duhur se si duhet të shërbehet një klient. Kështu ngjan edhe me shitësit me përvojë të gjatë për shkak se te disa prej tyre nuk ndryshojnë kurrë as idetë, as sjelljen dhe vështirë i pranojnë idetë e të tjerëve se si të shërbehet apo se si të shitet një produkt. Mendimi se çka mendon klienti për ne është gjithçka çfarë ne kemi. Në kuadër të shërbimit cilësor vlen të përmendet kalimi në të gjitha fazat e procesit të shitjes sepse nëse dëshirojmë të bëjmë një shërbim të mirë, respektivisht shitje të shëndoshë, e që nënkup-

ton të preken të gjitha fazat nga përgatitja deri te përcjellja e prezantimit pas shitjes së produktit, duhet të kalohet nëpër secilën fazë, edhe nëse shitja kryhet për pesë minuta. Ka raste kur mund të kapërcehet ndonjëra, por vetëm kur kemi të bëjmë me atë që quhet klient inteligjent.

Llojet e klientëve

Në cilëndo kategori që bën pjesë produkti apo në cilëndo industri, e pëlqyeshme është që klientët të ndahen në:

- klientë inteligjentë - klientë që bëjnë kërkime dhe pyesin shumë persona rreth produktit, pastaj vijjnë në kompani por që, nëse shitësi ka aftësitë e duhura, do të jetë kënaqësi për të t'i shërbejë dhe t'i përgjigjet;
- klientë sfidues - fokusimi i të cilëve nuk është te çmimi, por që natyrshëm janë të vështirë;
- klientë që nuk bazohen në vlerë, por në çmime, të cilët nuk i sjellin klientët të tjerë kompanisë, që nuk u tërheq vëmendje përkushtimi juaj por, thjesht, u intereson vetëm çmimi;
- klientët, blerjet e të cilëve bazohen në ndjenja, klientë që blejnë produkte për të vetmen arsye "më bën të ndihem mirë" dhe nuk e diskutojnë çmimin.

Klientët mund të ndahen edhe në grupe të tjera, por në më pak grupe nuk do të duhej të ndaheshin.

Kur e përmenda shërbimin cilësor mendoj se shpesh keqkuptohet që t'i aprovohet çdo gjë klientit që kërkon. Jo. Mendoj se shërbimi cilësor ndaj klientit nënkupton edhe kur diçka nuk është e mundur të bëhet por që, nëse ekziston mundësia, klienti të ulet, të qetësohet, të shërbehet me kafe apo ujë apo në çfarëdo forme tjetër dhe t'i tregohet gjerësisht se pse një gjë e tillë nuk është e mundur të bëhet. Kështu veç e forcon besimin e klientit. Gjithashtu, ndjeshmëria dhe dëgjimi dhe alternativat kanë shumë rëndësi. Do të thotë, kalimi në anën emocionale të klientit, për ta kuptuar situatën e tij më mirë. Nëse e bëjmë këtë gjë do të shohim se nuk mjaftojnë vetëm thëniet programuese të frohta pa pikën e ndjenjës te shumica dërrmuese e shitësve "më fal" dhe "më vjen keq", "po ju kuptoj", "nuk është përgjegjësi e imja". Po ashtu, mosdërrerja e klientit dhe mosbërja e arsyetimeve për ta mbrojtur vetveten nga ana e shitësit derisa është duke folur klienti, qoftë me vend apo jo, ajo çka klienti është duke thënë, ka shumë rëndësi për zbutjen e tensionit, përndryshe, po të reagohej në këto raste, vetëm do ta irritojë atë.

Zoran Tegeltija, kryeministër i Bosnjë e Hercegovinës

SARAJEVË, 5 DHJETOR - Parlamenti i Bosnjë e Hercegovinës të enjten zgjodhi kryeministrin e ri të vendit. Zoran Tegeltija do të jetë kryetar i Këshillit të Ministrave në mandatin e ardhshëm katërvjeçar. Në fjalimin e tij para parlamentit, Tegeltija tha se rruga evropiane e vendit është çështja kryesore me të cilën do të merret gjatë ushtrimit të mandatit. Ndër prioritetet e tjera, ai përmendi krizën e migrantëve, zhvillimin ekonomik dhe

punësimin e të rinjve. "Për më shumë se një vit Bosnjë e Hercegovina nuk ka arritur ta formojë qeverinë. Është detyrim yni ta kompensojmë kohën e humbur në periudhën e ardhshme", tha Tegeltija. Kryeministri i ri i Bosnjës i takon Unionit Social Demokrat të udhëhequr nga anëtari serb i presidencës trepalëshe, Millorad Dodik. Tegeltija, gjithashtu, tha se Këshilli i Ministrave duhet t'i zbatojë reformat sa më shpejt

që të jetë e mundur në mënyrë që të vazhdojë procesi i integritimit evropian. Bosnjë e Hercegovina ka qenë pa qeveri në nivel federal, për më shumë se një vit, sepse liderët e partive nuk arritën një marrëveshje pas zgjedhjeve. Mospajtimet kryesore kishin të bënin me miratimin e Planit vjetor kombëtar, dokument që përfaqëson vendin me Aleancën Veriatlantike (NATO). Anëtari serb i presidencës, Millorad Dodik, ka kundërshtuar miratimin e planit.



Abuzimi i pushtetit nga presidenti Trump, shkelje që meriton shkarkimin

Ligjvënësit demokratë thonë se prova është e qartë: presidenti Donald Trump vonoi ndihmën amerikane për Ukrainën me qëllim të përfitimit të interesave të veta personale politike, prandaj ata ndërmorën hapin e radhës në procesin hetimor për shkarkimin e tij

WASHINGTON, 5 DHJETOR - Ligjvënësit demokratë ndërmorën hapin e radhës në procesin hetimor për shkarkimin e presidentit Donald Trump. Katër ekspertë ligjorë dhanë opinionin se çfarë thotë Kushtetuta amerikane për standardet e shkarkimit të një presidenti përmes hetimeve. Raundi i ri i seancave dëgjimore në Komisionin e Ligjeve e ka afruar më shumë mundësinë e votimit të neneve të akuzës përpara fundit të vitit dhe zhvillimin e një gjyqi në Senat që do të vendosë nëse presidenti do të hiqet nga detyra, ka njoftuar voa.

Ligjvënësit demokratë thonë se prova është e qartë: presidenti Donald Trump vonoi ndihmën amerikane për Ukrainën me qëllim të përfitimit të interesave të veta personale politike. "Ai ishte i gatshëm ta komprometonte sigurinë tonë dhe detyrën e vet për përfitime personale politike. Nuk ka rëndësi që presidenti Trump u zbulua dhe rrjedhimisht i lëvroi fondet që i duheshin aq shumë Ukrainës. Ajo që ka rëndësi është se ai rekrutoi një qeveri të huaj për të ndërhyrë në zgjedhjet tona",

tha Jerrold Nadler, kryetar i Komisionit të Ligjeve të Dhomës së Përfaqësuesve.

Nadler udhëheq tashmë procesin hetimor. Ai u kërkoi ekspertëve të Kushtetutës të përcaktojnë nëse veprimet e presidentit Trump shkelën betimin e tij dhe nëse ndaj tij duhen ngritur akuza me qëllim shkarkimin. "Abuzimi i pushtetit ndodh kur presidenti shfrytëzon pushtetin e vet, pushtetin mbresëlënës të postit të tij, për të mos i shërbyer publikut amerikan, por për t'iu shërbyer interesave të veta personale, individuale, partiake dhe elektorale", tha Noah Feldman, i Shkollës Juridike të Harvardit.

Abuzimi i pushtetit klasifikohet ndër krimet e rënda dhe ndër shkeljet për të cilat mund të shkarkohesh, thanë ekspertët. "Nëse kjo që po diskutojmë nuk përbën baza për shkarkim, atëherë asgjë tjetër nuk do të ishte e tillë. Ky është pikërisht lloji i veprimeve të papranueshme për të cilat etërit krijuan Kushtetutën që të na mbrojnë", tha Michael Gerhardt, Shkolla Juridike e Karolinës së Veriut.

Por, jo të gjithë ekspertët ranë



dakord. "Mendoj se ky proces hetimor jo vetëm që nuk përmbush standardet e proceseve të kryera më parë, por do të krijojë një precedent të rrezikshëm për proceset hetimore të së ardhmes", tha Jonathan Turley, profesor në Universitetin George Washington. Republikanët thanë se ish-in shqetësimet e presidentit Trump për korrupsionin në Ukrainë që motivuan veprimet e tij. "Është një vend për të cilin ai pati shqetësime që në fillim. E keni parasysh që ai ka shqetësime për asistencën ndaj vendeve të tjera, por në veçanti për vendin në fjalë", tha ligjvënësi republikan

Doug Collins.

Presidenti Trump ngriti pikëpyetje rreth arsyeve pse demokratët ndërmorën hapin serioz të procesit hetimor. "Për këta njerëz pothuajse të lind pyetja nëse e duan vendin tonë apo jo?", u tha gazetarëve presidenti Trump. Me zgjedhjet presidenciale të 2020-s që po afrohen, demokratët thonë se nevoja për të vepruar është urgjente. "Nuk kemi luks të presim, ndërsa presidenti vazhdon t'u kërkojë vendeve të tjera të përfshihen në zgjedhjet tona", tha ligjvënësi demokrat Eric Swalwell. Profesor Turley i paralajmëroi demokratët të mos nxitohen me

ngritjen e akuzave. "Caktuat një periudhë kohore jashtëzakonisht të shkurtër. Kërkoni sasi tepër të mëdha informacioni, dhe kur të dalë presidenti në gjyq, ju do ta akuzoni. A ju përputhet kjo me ato çfarë keni dëgjuar rreth shkarkimeve përmes procesit hetimor? A përputhet kjo me funksionimin e shtetit ligjor për të cilin po flasim?", u tha ligjvënësve profesor Jonathan Turley. Komisioni i Ligjeve pritet të organizojë dëgjesa të tjera javën e ardhshme, ndërsa ekziston mundësia që Dhoma e Përfaqësuesve të votojë për ngritjen e akuzave brenda këtij muaji.

Protestat paralizojnë Francën, mbyllen shkollat dhe metrotë

PARIS, 5 DHJETOR - Emmanuel Macron përballet me grevat më të mëdha gjatë gjithë presidencës së tij. Aksionit i janë bashkuar punonjësit e hekurudhave, kontrollorët e trafikut ajror, mësuesit dhe punonjësit e sektorit publik, të cilët lanë punën dhe dalën nëpër rrugë për të ngritur zërin kundër ndryshimeve të propozuara në sistemin e pensionit. Shërbimet hekurudhore janë

pezulluar thuajse tërësisht e mendohet se ngërçet e transportit mund të zgjasin për disa ditë me radhë. Në Paris, janë mbyllur 11 nga 16 linjat e metrosë; në shumë shkolla nuk po bëhet mësim, e është paralajmëruar edhe një "mbyllje simbolike", e disa stacioneve policore. Dyqanet në rrugën që ndjekin protestuesit janë këshilluar të mbyllen për shkak për episodeve të mundshme të

dhunës.

Gati gjysma e udhëtimeve të trenave Eurostar mes Parisit dhe Londrës janë pezulluar. Turistët janë këshilluar gjithashtu që për shkak të situatës së krijuar, t'i qëndrojnë larg Kullës Eiffel. Këto greva konsiderohen si një test i fuqishëm për presidentin Macron, i cili reformën e sistemit të pensioneve e kishte në mesin e premtimeve më të rëndësishme të fushatës.





AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E rrallë

Qiratë e larta i çojnë punonjësit në shtëpi 5 metra katrorë

Një fotograf ka kapur kushtet e "goshitelëve" ku jetojnë me mijëra studentë ose punonjës me pagë të ulët që nuk përballojnë dot qiranë e lartë të kryeqytetit industrial, Seulit. Goshitelet janë shtëpi që ofrojnë kuzhina dhe banja të përbashkëta dhe që janë ndarë në shumë dhoma të vogla, më pak se 5 metra katrorë, ku banorët detyrohen të ngjeshën vetë bashkë me rrobat, pajisjet e gjërat e tjera që kanë në pronësi. Këto dhoma u shfaqën për herë të parë në vitet 1970, kur u ndërtuan si një hotel i lirë për të pritur stu-



dentë që vinin për pak ditë, kur duhej të përgatiteshin për provime. Por tani u jepen me qira njerëzve që kanë ardhur në qytet për të bërë punë me pagë të ulët dhe që nuk i përballojnë dot çmimet e shtëpive të kryeqytetit, Seul, të cilat sa vijnë e rriten për shkak të zhvillimit industrial. Këto dhoma kushtojnë nga 70 deri në 140 euro në muaj.

FOTO E DITES




Një punëtor në New Delhi të Indisë shihet duke transportuar një ngarkesë të madhe të mbeturinave. /AFP/

E jashtëzakonshme

Kapet nëndetësja e parë me drogë në Evropë, 3 000 kilogramë kokainë

Policia spanjolle arrestoi kapitenin që kishte arritur të largohej nga një nëndetësë droge që u kap në brigjet e Spanjës më 24 nëntor, me 3 000 kilogramë kokainë brenda. Kapiteni nga Galicia u arrestua në Pontevedra, ndërsa dy anëtarët e



tjerë të ekuipazhit, ekuadorianë, u patën kapur kur qe ndaluar nëndetësja. Kjo është nëndetësja e parë e drogës që kapet në Evropë.




DASHI

Nëse doni ta rrisni vetëbesimin e dikujt, është mirë ta merrni dhe të diskutoni me të me qetësi për ngjarjet e fundit që i kanë ndodhur.



DEMI

Sot do të rriteni shpirtërisht duke dëgjuar muzikë të mirë dhe duke ndenjur në ambiente intelektuale që kishin kohë që ju mungonin.



BINJAKËT

Nëse keni marrë përsipër të përkohshëm një rrugë të caktuar nuk duhet të keni më mëdyshje. Çdo kthim pas do t'ju kushtojë.



GAFORRJA

Shumë objektiva tuajat po i anashkaloni vetëm për një hutim të çastit. Do të jetë më mirë të kërkonti këshilla te personat e duhur.



LUANI

Po ju jepen shumë mundësi në karrierë dhe jeni të dyzuar ndërmjet oportuniteteve që do të zgjidhni. Kërkoni mendimin e familjes.



VIRGJËRËSHA

Çdo gjë po shkon më së miri nga ana sentimentale. Ju ndiheni në qiellin e shtatë nga një dhuratë që jua ka bërë partneri.



PESHORJA

Momenti më i mirë i ditës suaj është mëngjesi. Keni kohë të mendoni për çdo gjë dhe jeni më produktiv dhe energjik.



AKREPI

Duhet t'i shfrytëzoni informacionet e reja që do të merrni dhe nuk keni pse merrni kohë që të mendoheni. Çdo gjë ka për të shkuar siç e keni vendosur.



SHIGJETARI

Sot po reflektoni mbi çështje që më parë ju janë dukur shumë të thjeshta. Keni anashkaluar gjëra të rëndësishme që tashmë janë bërë probleme.



BRICJAPI

U bë disa kohë që një person i caktuar po ju bezdis lidhur me një temë që ju nuk dëshironi ta prekni. Sot do të tregoheni shumë i prerë.



UJORI

Sot do të keni surpriza pozitive dhe negative. Keni lënë për shumë kohë pezull një situatë që tashmë ka degjeneruar.



PESHQIT

Edhe pse në ambientin e punës mund të keni probleme të vogla, personat që ju rrethojnë, nuk kanë qëllime negative karshi jush.

BARSOLETA E DITËS



Burrë e grua flasin për pushimet por, para se të vendosin, e shohin nëse kanë buxhet. Pasi e analizojnë buxhetin, burri thotë:
- Valla unë nuk kam nevojë për pushime, se nuk jam aspak i lodhur.
Gruaja:
- Valla as unë, se po ndihem shumë në formë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC


Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

Rolet: Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.

Regjia: Conrad Vernon And Greg Tiernan



Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

Rolet: Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

Regjia: Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

Rolet: Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfé, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.

Regjia: James Mangold



Çdo natë në ora 21:30 TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min


Rolet: Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

Regjia: Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

Khloe nuk e dëshiron rikthimin me Tristan



Khloe Kardashian nuk është e interesuar për një marrëdhënie romantike me ish të dashurin Tristan Thompson. Gjatë një episodi të fundit të "Keeping Up With The Kardashians", basketbollisti 28-vjeçar

u pa duke ia dhuruar Khloes një unazë për ditëlindjen e saj. "Po, ai po përpiqet ta rikthejë atë", tha një burim për "People". Disa muaj pas tradhtisë, Khloe ende nuk e mendon rikthimin me të.

E dashura 22-vjeçare e Di Caprios për herë të parë flet për hendekun e moshës që kanë



Aktorja e kthyer në modele Camila Morrone është mërzhitur nga hendeku 23-vjeçar mes vetes dhe të dashurit Leonardo DiCaprio. "Ka kaq shumë marrëdhënie në Hollywood dhe në historinë e botës ku njerëzit kanë boshllëqe të mëdha në moshë", ka thënë 22-vjeçarja për "Los Angeles Times" për të dashurin e saj 45-vjeçar. "Unë thjesht mendoj se çdokush duhet

të dalë me çdokënd që dëshiron", është shprehur Morrone. Përderisa bukuroshja e re zgjodhi të injorojë ata që nuk e aprovojnë këtë, tha se ajo nuk e kupton interesin që e shfaqin fansat në jetën e Leos. Morrone ka pohuar se ka shpresa që përmes filmit të saj të ri "Mickey and Bear" do të mund të krijojë një personalitet të ri në publik, jashtë atij që i është krijuar nga i dashuri i saj i famshëm.



Motra 63-vjeçare e Michael Jacksonit, magjepsëse

La Toya Jackson dukej jashtëzakonisht magjepsëse kur doli jashtë për punë përditshme në Beverly Hills. Këngëtarja dhe motra 63-vjeçare e yllit të muzikës pop, të ndjerit Michael Jackson, shfaqti figurën e saj në një triko të zezë të përshtatur, duke u shtrirë

me një pallto të gjatë. Ajo po shtrëngonte një qese ndërsa mbante në supë një çantë portokalli të cilën e kishte kombinuar me mbathje të lehta. Këngëtarja amerikane mbronte sytë me një palë syze dielli të stilit aviator dhe i shtoi një buzëkuq pamjes së makeupit.

Aktorja Emma Stone fejohet me David McCary








Aktorja Emma Stone është fejuar me të dashurin e saj, producentin e "Saturday Night Live", David McCary. Ky i fundit e ka postuar në "Instagram" një fotografi të çiftit ku aktorja shihet me unazën e fejesës. Çifti që kanë tentuar ta ruajnë privatësinë e lidhjes së tyre, pasi nuk donin shumë vëmendje në publik, e kanë



nisur lidhjen e tyre të dashurisë në muajin tetor të vitit 2017.

Jehona e Enciklopedisë Gjithkombëtare, 'Bardhësitë e Atdheut'...

Enciklopedia gjithëkombëtare me 3000 heroina, heronj të tri luftërave çlirimtare të UÇK-së, në Kosovë, Kosovë Lindore dhe Maqedoni nderohet nga atdhetarët e veçantë gjithëkombëtarë: Gjeneral-letnjant, Agim Çeku, ish shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Agim Ademi, veprimtar i mirënjohur sportiv dhe kryetar aktual i FFK-së, Kadri Morinaj, drejtor dhe pronar i Kompanisë së Sigurimeve, "EUROSIG". z. Moerinaj tha se Enciklopedia gjithëkombëtare, "Bardhësitë e Atdheut" e autorit të vyer Afrim Mustafa, sa më parë duhet ta shohë dritën e përkthimit në gjuhë e ndryshme të botës, e posaçërisht në anglisht. Për përkthimin e kësaj vepre madhore është shprehur edhe komandanti i mirënjohur i UÇK-së, Zona Operative e Nerodimes, Gjokë Shalaj, Shalaj, i cili ishte komandant i brigadës 163 të UÇK-së, tha se: mbërritja në Kongresin Amerikan e kësaj Enciklopedie me shumë vlerë do të jetë një arritje e madhe... Enciklopedinë e përmasave gjithëkombëtare e lartësojnë edhe dy komandantët e shquar të UÇK-së, të cilët ndër organizaorët e luftës çlirimtare në Kosovë: Gjeneral, Daut Haradinaj dhe komandanti nga Ratkoci i Rahovecit, Smajl Latifi. Po ashtu, Ruzhdi Gashi, një veprimtar i njohur dhe avoka nga qyteti i Suharekës ka thënë se është urgjent përkthimi i Enciklopedisë së përmasave gjithëkombëtare "Bardhësitë e Atdheut". Këtë e kan kërkuar edhe komandanti i njohur i UÇPMB-së, Lulzim Ibishi, por edhe komandanti i mirënjohur i UÇK-së, Binak Gashi. Me librin e veçantë në duar shihen edhe: ish kryeministri i parë i lirisë së Kosovës, mjeku i luftës, dr. Bajram Rexhepi, futbollisti me famë botërore Xherdan Shaqiri, veprimtarët: Ndue Çollaku nga Prizreni, aktori Eqrem Berisha nga "Odeon", veprimtarët: Rexhë Xhakli nga SHBA, Shefqet Dibrani, shkrimtar i mirënjohur, ish drejtori politik i UÇPMB-së, Jenuz Musliu, veprimtari, atdhetari dhe humanitari, Mikel Kuzhnini, veprimtari dhe pajtimtari Behram Hoti, veprimtarja, Violeta Pirraku- Bjaraktari, ish komandanti i mirënjohur i UÇK-së, Jetullah Çarri-"Guri", gazetari dhe publicisti i njohur, Shaqir Foniqi, ish komandanti i njohur i UÇK-së, Islam Kelmendi- "Isë Zllashi" etj.



Filmi "Exil" nga Kosova, në garën kryesore në "Sundance Film Festival"



Është publikuar lista e filmave për "Sundance Film Festival", një ndër festivalet më të rëndësishme të filmit në botë. Në garë

është edhe filmi i regjisorit nga Kosova Visar Morina, i cili do të prezantohet me filmin e metrazhit të gjatë "Exil".

Filmi rrëfen tregimin e Xhaferit, një inxhinier i kimisë me origjinë nga Kosova, i cili ndjehet i diskriminuar dhe i ngac-

muar në vendin e punës, gjë që e zhytë atë në krizë të identitetit.

Në film luajnë: Sanrda Hüller,

Misel Matieviq, Astrit Kabashi, Valentina Dubovci, Flonja Kodheli, Getuart Hajrizaj, Ameli Kabashi...

Arkivat për udhëtarët e huaj në tokat shqiptare

Në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë, Gadishulli i Ballkanit njëhej shumë më pak në Evropë, sesa kolonitë e saj nëpër botë...!


Studiuesi dhe historiani Dorian Koçi shprehet se kjo mosnjohje reflektohej drejtpërdrejt edhe në librat e gjeografisë, ku këto territore, përfshirë dhe tokat shqiptare, quheshin thjesht provinca të Turqisë, por paradoksalisht për emërtimin e lumenjve dhe maleve të tyre përdorej ende onomastika e vjetër greko-latine.

Përse, duke nisur që nga fundi i 1700-s, dhjetëra udhëtarë evropianë vërshuan në trojet shqiptare. Këto pikëpyetje dhe kërkimet e vazhdueshme të studiuesit Dorian Koçi çuan në hartimin e librit "Imazhi i

Shqipërisë dhe shqiptarëve në Angli."

Në këtë libër Koçi ka shkruar për udhëtimet dhe veprat e autorëve anglezë që bënë eksplorimin e viseve shqiptare, si Bajroni, William Leake, Edward Lear, Edith Durham etj. "Franca, dhe më vonë Anglia, e gjetën veten shumë shpejt në 'aktorë' dhe 'faktorë' të rëndësishëm politikë, kulturorë dhe socialë në teatrin diplomatik të këtyre viseve. Kjo prani evropiane dhe rinjohjeje u përforcua më tepër nga një fenomen i rëndësishëm, thotë Koçi.

/Report Tv/



Shitet vepra e Gogenit

Një pikturë e autorit francez Gogen (Paul Gauguin) u shit në ankand në Paris për 9,5 milionë euro, rreth dy herë më shumë nga vlerësimi që i ishte bërë, deklaroi shtëpia e ankandit "Artcurial".

Piktura 'Te Bourao II', një punë e krijuar gjatë periudhës në të cilën artisti ishte në Tahiti. Piktura ka ngjalli një interes të madh dhe u ble nga një koleksionist ndërkombëtar, por do të mbetet në Francë", deklaroi

"Artcurial".

"Te Bourao II" ose "Pema e Pura" në gjuhën vendase, është pjesë e një serie prej nëntë veprash që krijoi Gauguin në vitin 1897 dhe është e vetmja që është ende në duar private.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Milicaj: Mbijetesa, mision i vështirë për Dukagjnin

Mark Milicaj për "Epokën e re" e ka pranuar faktin se Dukagjini e ka të vështirë të mbetet në Superligë edhe për kampionatin e ardhshëm. "Realisht nuk kemi pasur një sezon të mirë në bazë të rezultateve dhe renditjes në tabelë. Kur e kemi parasysh faktin se katër skuadra do të bien nga Superliga, atëherë mund të them se sigurimi i mbijetesës do të jetë shumë i vështirë", ka thënë Milicaj



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 5 DHJETOR - KF Dukagjini nga Klina u inkuadrua me shumë bujë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Kjo skuadër bëri shumë përf forcime dhe emëroi edhe trajnerin e ri para edicionit 2019/2020, por deri tash gjitha këto i kanë shkuar huq për faktin se pati një sezon shumë të dobët dhe përfundoi e fundit në tabelë. Një prej futbollistëve kryesorë në këtë klub, Mark Milicaj, ka thënë të enjten për "Epokën e re" se klubi nga Dukagjini do ta ketë të vështirë sigurimin e mbijetesës, sepse në këtë edicion të garave largohen katër klube nga IPKO Superliga. "Realisht nuk kemi pasur një sezon të mirë në bazë të rezultateve dhe renditjes në tabelë. Kur e kemi parasysh faktin se katër skuadra do të bien nga Superliga, atëherë mund të them se sigurimi i mbijetesës do të jetë shumë i vështirë", ka thënë Milicaj.

Skuadra e Dukagjinit ishte më e mirë në garën e Kupës, ku e eliminoi nga kjo garë skuadrën me traditë të madhe në futbollin e Kosovës, Besën e Pejës. Në 1/8 e finales skuadra e Dukagjinit do të përballet me Vitinë. Milicaj beson se

REZULTATET E DUKAGJINIT:	
Dukagjini - Ballkani	0-0
Prishtina - Dukagjini	2-0
Dukagjini - Drita	0-4
Flamurtari - Dukagjini	2-0
Dukagjini - Ferizaj	0-1
Dukagjini - Feronikeli	0-2
Llapi - Dukagjini	2-1
Dukagjini - Trepça '89	1-0
Gjilani - Dukagjini	1-0
Dukagjini - Vushtrria	1-0
Drenica - Dukagjini	3-0
Ballkani - Dukagjini	3-0
Dukagjini - Prishtina	0-0
Drita - Dukagjini	1-0
Dukagjini - Flamurtari	1-2
Ferizaj - Dukagjini	2-0
Feronikeli - Dukagjini	4-2

skuadra nga Klina do të kalojë edhe këtë rreth dhe do të mund të shkojë sa më lart që është e mundur. "Duke mos dashur ta nënçmoj kundërshtarin, besoj se edhe këtë xhiro do të kualifikohem. Kupën do ta ndjekim se kemi mundësi, por shpresoj të kemi edhe fat", ka shtuar Milicaj. Përveç që arriti më së paku fitore dhe u pozicionua në fundin e tabelës, Dukagjini është dalluar në këtë sezon edhe për sulm të dobët. Nga shtatëmbëdhjetë ndeshjet e zhvilluara kjo skuadër realizoi vetëm gjashtë gola, kurse pranoi plot 29 gola. Ish-sulmuesi i shumë klubeve në Kosovë, Mark Milicaj, ka kontratë me skuadrën e Dukagjinit edhe gjashtë muaj. "Po ta shohim çfarë do të ndodhë në të ardhmen. Kam kontratë gjashtë muaj me Dukagjinin, por duhet të ulem të bisedoj me kryesinë dhe të shoh cilat janë planet e klubit për të ardhmen e pastaj do të vendos, por Dukagjini do të jetë primar", ka shtuar Milicaj.

SHKURT

Krasniqi: Joshua do ta fitojë rimeçin ndaj Ruizit

Ish-kampioni evropian në kategorinë e rëndë të boksit, Luan Krasniqi, ka thënë se Anthony Joshua do ta fitojë rimeçin e shumëpritur me Andy Ruiz Jr, të shtunën në Arabinë Saudite dhe, si rrjedhojë, do t'i kthejë në pronësi titujt e humbur IBF, WBA dhe WBO. "Kemi mendime shumë ta ndara për atë se kush do ta fitojë rimeçin. Edhe unë jam një nga ta. Personalisht mendoj se Anthony Joshua do të dalë nga ringu si fitues", ka shkruar Krasniqi në "Facebook". "Megjithatë, është e nevojshme që ai (Joshua) të boksojë mençur dhe me kontroll", ka shtuar Krasniqi.

Hadërgjonaj, bashkëlojtar me Muriqin?

Florent Hadërgjonaj mund të largohet nga Huddersfield në afatin kalimtar të janarit. Mbrojtësi i krahut i "dardanëve" mund të vendosë për një afrim te Fenerbahçe në janar, për t'u larguar nga Huddersfield Town. Klubi turk do ta përdorë Vedat Muriqin për ta bindur Hadërgjonajn. Lojtarët kanë raporte të mira në Përfaqësuesen e Kosovës dhe kjo mund të ndikojë që të bashkohen në Superligën e Turqisë, te Fenerbahçe.

Krasniqi pret lejen e FIFA-s për ta përfaqësuar Malajzinë

Futbollisti nga Kosova, Liridon Krasniqi, është në pritje të lejes për ta përfaqësuar Malajzinë. Mesfushori i lindur në Viti, që më parë e ka përfaqësuar Shqipërinë në grupmoshat U-21 dhe është paraqitur në tri ndeshje miqësore me Kosovën, është ambientuar mjaft mirë në futbollin aziatik. Që prej muajit maj Krasniqi është futbollist i lirë, megjithatë më parë ai ka luajtur te dy klubet nga Malajzia, Kedah dhe Melaka United. Kombëtarja e Malajzisë ka treguar interesim për ta angazhuar Krasniqin, por FIFA ende nuk ka dhënë ndonjë leje. Presidenti i Federatës së Futbollit të Malajzisë, Yusoff Mahadi, ka bërë me dije se Krasniqi është duke e pritur lejen nga FIFA. "Sa i përket Liridon Krasniqit, ne jemi ende duke prituri leje nga FIFA", ka thënë Mahadi.

Ministria e Administratës Publike: Agim Ademi ka fituar mandat katërvjeçar

PRISHTINË, 5 DHJETOR - Derisa Zyra Ligjore e Ministrisë së Sportit kishte dhënë opinionin se në Kuvendin e FFK-së të korrikut të vitit 2018 kishte parregullsi në procesin e zgjedhjes së Agim Ademit kryetar të FFK-së, prej të cilit

opinion u distancua ministri Kujtim Gashi që ka thënë se atë e ka shkruar një individ, lidhur me këtë rast opinionin ka dhënë edhe Ministria e Administratës Publike. Departamenti i OJQ-së i kësaj ministrie i ka dhënë opinion

FFK-së, përmes të cilit Agim Ademi vlerësoi si legjitim, me mandat katërvjeçar. Sipas këtij opinionit të Ministrisë së Administratës Publike, Ademi gëzon mandat deri në vitin 2022, e jo deri në vitin 2020, siç kërkon grupi i tij opozitar.

"Është evidentuar e tërë procedura e zhvilluar dhe rezultoni se janë respektuar dispozitat e Statutit me rastin e organizimit dhe mbajtjes së këtij kuvendi", thuhet në opinionin e kësaj ministrie, raporton "Express". "Përfaqësuesi i

autorizuar, kryetari i FFK-së, është zgjedhur me mandat 4 (katër)vjeçar, ashtu siç parashihet në nenin 39 të Statutit nga delegatët e Kuvendit të FFK-së", thuhet në opinionin e Ministrisë së Administratës Publike.

Shaqiri: Ëndërroj ta fitoj Premierligën

LIVERPOOL, 5 DHJETOR - Xherdan Shaqiri ka thënë se ëndërron ta fitojë titullin në Premierligë me Liverpoolin, pas një paraqitjeje brilante, duke e shënuar një herë në fitoren e të kuqve 5-2 kundër Evertonit. Anësori nga

Gjilani gëzoi 90 minuta lojë si rrallëherë në derbin e "Merseyside" dhe e shpagoi besimin e Jurgen Kloppit duke luajtur rol kyç në triumfin e Liverpoolit. Ylli i Kombëtares së Zvicrës shënoi golin e parë të

sezonit në rikthimin e tij nga lëndimi si titullar për herë të parë këtë edicion. "Ne duhet të fitojmë ndeshje. Kjo është më e rëndësishme. Të qëndrojmë në nivel të lartë, të rikuperohe mi mirë dhe pastaj shohim. Jemi

në formë të mirë dhe shpresoj se do të qëndrojmë në krye të ligës. Të jem i singertë, ëndërra ime më e madhe është ta fitoj Premierligën me këtë klub. T'ua jap tifozëve titullin pas 30 vjetëve", ka shtuar Shaqiri.



Ibraimi: Krenar për rekordin, por synoj të vazhdoj të shënoj

TETOVË, 5 DHJETOR - Sulmuesi kërcëzues i Shkëndijës së Tetovës, Besart Ibraimi, ka kohë që llogaritet në mesin e golshënuesve më të mirë në historinë e futbollit në Maqedoninë e Veriut. Pas rekordit si futbollisti i parë që fiton tri herë rresht titullin "Këpuca e Artë" (golshënuesi i sezonit) në elitën e Maqedonisë së Veriut, tashmë edhe zyrtarisht shkruan emrin e tij si autori i më shumë golave. Dy realizimet në fitoren e të dielës me Shkupin çojnë në 167 numrin e golave të Ibraimit. "Sigurisht se për mua është kënaqësi e veçantë të jem bartës i këtij rekordi dhe për këtë dua t'i falënderoj të gjithë ata që më kanë ndihmuar në rrugën time drejt kësaj arritje", ka thënë Ibraimi për faqen zyrtare të Shkëndijës. "Falënderimet i takojnë Zotit që më dha shëndet dhe mundësi të arrij këtë sukses. Pa dyshim, mirënjohës për bashkëlojtarët, trajnerët dhe gjithë në klub, bashkë me tifozët e Shkëndijës dhe 'Ballistët', pa mbështetjen e të cilëve nuk do të ishte e mundur kjo arritje. Një dedikim edhe për familjen që gjithmonë më ka përkrahur për të ecur përpara", ka shtuar ai. Me dy golat kundër Shkupit, Ibraimi



kompletoi 85 realizime kampionale me fanellën e Shkëndijës në Ligën e Parë, ku zhvillon sezonin e pestë si kuqez. Tri herë rresht doli golshënuesi i sezonit (25 gola në sezonin 2015/16, 20 gola në atë 2016/17 dhe 23 gola në sezonin 2017/18), për t'u ndalur në 11 gola (në vetëm 10 ndeshje) sezonin e shkuar, kur duhej t'i operonte ligamentet e kryqëzuar. Këtë fushatë, në kampionat, ka realizuar 6 herë dhe 2 gola në Kupë. Gjithsej në ndeshjet zyrtare me Shkëndijën, deri tani, Besarti ka realizuar 114 gola (85 në kampionat, 15 në Kupë dhe 14 në Kupat e Evropës). "Jam krenar për këto shifra që kam mundur të realizoj

me fanellën e Shkëndijës, për më shumë që ata gola kanë ndihmuar skuadrën t'i arrijë objektivat, si fitimi i titujve vendorë dhe ecuria pozitive në Evropë", ka deklaruar Ibraimi. Numri 7 i kuqezinjve shton se vazhdon të ndiejë uri për të shënuar sa më shumë gola. "Synoj të shënoj akoma me këtë fanellë. Pas operimit dhe pauzës ishte e pritshme të përballesh me vështirësi në drejtim të kthimit të formës optimale, por ngadalë gjërat marrin vendin e duhur. Pretendimi im është të vazhdoj të shënoj për ta ndihmuar Shkëndijën në ecurinë drejt objektivave", ka përfunduar Ibraimi.

Lakersat dominojnë në Perëndim, Milwaukee në Lindje

DETROIT, 5 DHJETOR - Lakersat vazhdon të dominojnë në renditjen në Konferencën e Perëndimit, pas fitores me rezultat 121-96 ndaj Utah Jazzit. Ndeshje e dominuar nga kalifornianët, që triumfuan falë Davisit, autor i 26 pikëve dhe Jamesit, 20 pikë dhe 12 asistime. Një moment të mirë po kalon edhe skuadra e Dallasit, që fitoi me shifrat 121-114 ndaj Minnesotas, sfidë ku herë udhëhiqte njëri ekip e herë tjetri. Powell me 24 pikë e Donçiqi me 22 bënë diferencën për teksanët në këtë sfidë. Fiton edhe skuadra e



Bostonit, që mundi 112-93 Miami, ndeshje me dy pamje. Miami dominoi në pjesën e parë (Butler 37 pikë), ndërsa në të dytën vjen rikuperimi i Celticsit, me Brownin (31 pikë) e Walkerin (28 pikë). Indiana me rezultat 107-100 e mposhti Oklahomën, ndeshje ku u dallua Warreni me 24 pikë, ndërsa Orlando e mposhti Phoenixin (128-114), falë 32 pikëve të

Gordon. Në Lindje vijon të dominojnë skuadra e Milwaukee, që mposhti 127-103 Detroit, me të zakonshmin Antetokounmpo që realizoi 35 pikë, lider në fushë për Bucksin. Skuadra e Chicagos, falë 25 pikëve të LaVine, mundi 106-99 Memphisin, ndërsa Brooklyn "hoqi qafe" Atlantën, duke fituar 130-118 (Temple 27 pikë e Dinwiddie 24 pikë).

SHKURT

Ibra thumbon CR7: Ronaldo i vërtetë është braziliani

Sulmuesi Zlatan Ibrahimović do të rikthehet në Serinë A dhe këtë e ka pranuar vetë në intervistën për GQ. Ai do të ketë një duel me Cristiano Ronaldon dhe marrëdhëniet mes të dyve nuk kanë qenë kurrë të mira me shtatartarin që e ka sulmuar disa herë. Kur u pyet se do të gjente një duel me Ronaldon në Serinë A, Ibra nuk u përmbajt dhe vazhdoi me të njëjtën melodi si zakonisht: "Aspak. Ronaldo i vërtetë është braziliani. Ai (i referohet CR7) nuk është një talent natyral, por fryt i një pune të madhe". "Ai firmosi me një ekip që kishte fituar Serinë A 7 herë radhazi. Nëse shkon në një klub të tillë nuk është sfidë. Nëse donte sfidë, të shkonte te Juventusin në Serinë B dhe ta rikthente në Serinë A dhe në krye të klasifikimit", ka deklaruar Ibra.

Reali, pa Hazardin dhe Marcelon ndaj Barçës

Real Madridi do të luajë "El Clasicon" më 18 dhjetor ndaj Barcelonës. Lajm i keq për skuadrën e Zinedine Zidane's është mungesa e dy yjeve Eden Hazard dhe Marcelo. Lajmin e ka konfirmuar vetë klubi spanjoll, i cili duhet të përballet me konkurrentin kryesor për titull pa dy nga lojtarët kryesorë të skuadrës. Reali dhe Barcelona ndajnë dy pozitat e para me nga 31 pikë të grumbulluara.

Silva në 'radar' të Galatasarayt

E ardhmja e Thiago Silvës mbetet ende mister. Mbrojtësi brazilian vijon të lëshojë deklaratat dashurie për Paris Saint Germainin, ndërsa drejtuesit e klubit francez ende nuk po ofrojnë rinovimin me parametrat që lojtari dëshiron. Në muajt e fundit me klubin francez, Thiago Silva ka përfunduar në radarët e Galatasarayt, që e konsideron mbrojtësin veteran si goditjen e përkryer në afatin kalimtar të janarit. 35-vjeçari dëshiron të qëndrojë ende në Evropë, mundësisht në Paris, por këta të fundit e shikojnë ndryshe ndaj dhe rrugët pritet të ndahen verën e ardhshme.

UEFA ndryshon sistemin e kualifikimeve për botërorin Katari 2022

Federata Evropiane e Futbollit (UEFA) ka ndryshuar sistemin e kualifikimit për Kupën e Botës 2022 në Katar. Në kualifikime do të paraqiten 55 ekipe evropiane që garojnë për 13 vendet që Evropa do të ketë në Katar. Ekipet do të ndahen në 10 grupe - pesë me pesë ekipe dhe pesë me gjashtë ekipe. Dhjetë fituesit do të kualifikohen drejtpërdrejt në Kupën e Botës, ndërsa dhjetë garues-plus dy skuadra të Ligës së Kombeve 2020/21 do të shkojnë në kualifikime shtesë për tri vendet e mbetura. Përfaqësueset do të ndahen në tri grupe me katër ekipe dhe vetëm fituesi i secilit grup do të sigurojë pjesëmarrjen në botëror. Do të ketë dy gjysmëfinale dhe finale në secilin grup. Në kualifikimin për Kupën e fundit botërore në Rusi më 2018 skuadrat evropiane u ndanë në nëntë grupe, nga të cilat fituesit shkuan drejtpërdrejt në Kupën e Botës dhe tetë garuesit më të mirë të vendeve të dyta në "play-off".

Messi: Mane meritoi me shumë se pozita e katërt

Lionel Messi e ka pranuar se është 'turp' ta shohësh sulmuesin e Liverpoolit, Sadio Mane, të përfundojë në vendin e katërt në renditjen e "Topit të Artë" për vitin 2019. Mane ka qenë figurë kryesore në sulmin e Liverpoolit këtë vit, duke ndihmuar klubin ta fitojë Ligën e Kampionëve dhe duke luajtur një rol kryesor në shtytjen e klubit drejt titullit të Ligës Premier. "Është turp ta shohësh Manen të përfundojë në vendin e katërt. Por, mendoj se ka pasur shumë lojtarë të shkëlqyeshëm këtë vit. Kjo ishte arsyeja pse ishte e vështirë të zgjedhësh një lojtar të veçantë. Unë zgjodha Sadio Manen sepse ai është një lojtar që më pëlqen. Ai pati një vit të shkëlqyeshëm me ekipin e Liverpoolit. Prandaj e zgjodha. E përsëris, ka pasur shumë lojtarë shumë të shkëlqyeshëm këtë vit, kështu që zgjedhja ishte e vështirë", ka thënë Messi.

REZULTATET

Charlotte - Golden State	106-91
Detroit - Milwaukee	103-127
Orlando - Phoenix	128-114
Atlanta - Brooklyn	118-130
Boston - Miami	112-93
Chicago - Memphis	106-99
Oklahoma - Indiana	100-107
Dallas - Minnesota	121-114
Utah Jazz - Lakers	96-121
Portland - Sacramento	127-116



Autor: GAZMEND MORINA		VENDOSJA E DIÇKAJE NË NJË VEND	VIJË E HAPUR NGA UJËRAT E SHIRAVE	ERA E KËNDSHME	AKTORI AMERIKAN RICHARD (shqip.)	PËRCAKTIMI I NUMRIT RENDOR TË REGJISTRIT; REGJISTRIMI	ZANORE	PËRFUNDIMI TEORIK, QË NXIRRET NËPËRMJET PËRFUNDIMIT SHKENCOR	SHKOJ, ECI (bised.)	VLERË, DOBI (krah.)	EPOKA E RE	PRODUKT ZJARRI
QË PRANON SI TË VËRTETË VETËM ATË QË ËSHTË E DOBISHME											BASHKËT. PERSON QË KA PASION PATOLOGJIK VENIEN E ZJARREVE	
KLUB I YNI FUTBOLLI							SKUADRA SPORTIVE I GJYMTUAR					
ZBUTJA OSE DOBËSIMI I NJË LËKUNDJE A GODITJE												BISKOTË E GATUAR ME ARRA (sh.shq.)
BASHKËT.			KËNGËTARJA KËRÇELI I ÇMPREH						EPOKË (shq.) ADEM JASHARI			
AKTORJA AMERIKANE FARROW					DY ZANORE MA JEP			GRIMCA MË E IMËT E ÇDO ELEMENTI				
ALBERTO TOMBA				AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT BASHKËT.				JEMENI REOMIR, IRIDIUM		MARC ANTHONY MUZIKANTI KRASNIQI		
QË BËHET SIPAS NJË NORME TË CAKTUAR; I									DRU MESDHETAR			
EPOKA E RE	EMËR MASHKULLI TË KRISHTERË	MODELJA JONË ÇUNMULAJ	SUPER MODELJA AMERIKANE CRAWFORD (shqip.)	PASIMI (Sport)	OKSIGJEN, NEON	ISMET PEJA "N" pas dy "T"		GJASHTARE PËRGËZIM		NËNË (krah.) QYTET NË MAQEDONI		
SUNDIMTAR ME PUSHTET ABSOLUT E TË PAKUFIZUAR						DY ZANORE		I PJEKURI; I MATURI KËNGËTARJA PERUANE ... SUMAK			BASHKËT. PRAPAVEP-RUESE	
LLOJ MINERALI QË PËRDORET PËR PLLAKA IZOLIMI						BURRA TË GUXIMSHËM DERA E VOGËL E THURUR ME THUPRA			FUTBOLLISTI ULIKS QË KA TË BËJË ME ILIRËT DHE ROMAKËT			
AKTORI FRANCEZ NË FOTO CASSEL (shqip.)						INVA MULA DY (turq.)		RITUAL TEFIK OSMANI		ELIZABETH TAYLOR SELEN		
SHTET I MADH NË AZI					FUTBOLLISTI BAJRAMI (TWENTE)	VARGJET E PËRPTHURA SHAMATA			HUMBUR (ang. orgj.) NOTË MUZIKORE			I ÇMENDUR
BURRË TRIM E BUJAR				I EPIKËS PRAROJ			FUTBOLLISTI ARGJENTINAS PABLO (BENFICA)	HISTORIANI ZVICERAN SCHMITT (shq.) KRIMB I DRURIT				
EPOKA E RE	GAZETARJA SHQIPTARE TARE	LLOJ SHEQERKE	LLOJ GAZI ME ERË TË KEQE E TË FORTË VEGËL MUZIKORE (sh.shq.)					TOKA E BUKËS REGJISORI QOSJA		OLIVER KAHN DY BASHKËTINGËLLORE		
I TURPËROVA							AXHAMI SMALTI		ZANORE KOHË KUR NIS TË ZBARDHË DITA (sh.pashq.)	ILAÇ		
KTHESEË RRUGË OSE LUMI						I DËRGUAR SPECIAL EMËR FEMRE MYSLIMANE				MJET PËR TË RRËSHQITUR MBI BORË BASHKËT.		
MBYS DIKË ME ARMË ZJARRI					KËNGËTARJA VALENTINA KUDRET ISAI			NIS TË ZBARDHË DITA ELIZA HOXHA		DY BASHKËTINGËLLORE SHKRONJA XVIII		
"R" pas dy "A"				VEND I HAPUR NË MURIN E NJË SHTËPIE SILIC				ISMET MUNISHI KRYEMURG		BREJTËSI I VOGËL RYSHFET		
EPOKA E RE	FEMRA E ZGJEDHUR HARK, KTHESEË				IRMA LIBOHOVA TRUP GJEOMETRIK		BANJË ALLATURKA NDËRTIM ME TË CILIN RRETHOJMË OBORRIN			VENEZIA, ROMA KRAHINË NË SHQIPËRI		
ROKERI AMERIKAN KRAVITZ (shqip.) FORTESEË					VEPËR E KRIMINELIT RIFAT ISMAJLI			KUNDREJT MALLKIME "RISANI"				TEFTA TASHKO
→				RETURN ON EQUITY BASHKËT.			GODINA MBI UJË BASHKËT.		SHKRONJË GREKE AUSTRIA		TOTENHAM ZANORE	
AKTORJA HOLIVUDIANE ZETA JONES (shqip.)						KLUB I YNI FUTBOLLI			PEZMATIM I VESHIT			



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerziteteska Bolnica i Klinicka Sluzba Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

Spitali Përgjithshëm Ferizaj (SPF) - Opsta Bolnica Urosevac(OBU) - Hospital General Ferizaj (HGF)

Drejtoria e spitalit përgjithshëm të Ferizajt, bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dhe neni 4 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe neni 5 i Rregullores Nr.1003/2016 mbi marrëdhënien e Punës të SHSKUK-së, si dhe aprovimin elektronik e dt.06.09.2019 nga drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK. Me datë 05.12.2019 shpallë këtë:

K O N K U R S

Institucioni :	Spitali Përgjithshëm Ferizaj
Titulli i vendit të punës:	Mjekë Specialist Oftalmolog
Kategoria funksionale/koefficienti:	II-659
Nëpunësi mbikëqyrës:	Shefi i repartit
Kohëzgjatja:	Për kohë të pacaktuar
Numri referencës:	922/19

➤ **Specialist Oftalmolog një (1) pozitë**

Qëllimi kryesor i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor e sasior bazuar në nivelin profesional që ka

Përgjegjësit kryesore të mjekut specialist:

- Bashkë me Shefin e repartit dhe stafin tjetër drejtues menaxhon me resurset humane, paisjet, objektet e inventarin për nivelin të cilit i takon.
- Siguron standarde të larta të përkujdesjes ndaj pacienteve.
- Mirësjellja, kujdesi dhe respektimi i pacientit dhe personelit punues.
- Mirësjellja dhe bashkëpunimi profesional me stafin tjetër punues.
- Pranimi, ekzaminimi e trajtimi përkatës i pacientit.
- Kryen evidencimin e rregullt përmes dokumentacionit mjekësor (historia e sëmundjes, fletlëshimi, protokollit etj) të pacientit.
- Kryen vizitat e rregullta tek pacientët e shtrirë në institucionin shëndetësor.
- Bënë kërkesa për vizita plotësuese-konsultative,
- Mbikëqyrë realizimin e detyrave ditore të punës të stafit punues.
- Jep mendime profesionale për punën që e kryen.
- Kryen detyra të tjera ashtu si kërkon mbikëqyrësi për mbarëvajtjen e punëve në institucionin ku është i punësuar.
- Kryen edhe detyra të veçanta kur i kërkohen lidhur me profesionin e ngushtë specialistik që e ka.
- Është përgjegjës për hartimin e plan-programit të punës së tij individuale e kolektive në vendin e punës,
- Angazhon stafin punues në realizimin e detyrave ditore të punës,
- Siguron dhe zhvillon programe e kurse trajnime profesionale,
- Bën kontrollin e rregullt (inspektimin e hapësirave, pajisjeve dhe të inventarit në vendin e punës).
- Siguron ambient të pastër e të sigurt për të gjithë,
- Menaxhon me material shpenzues dhe pajisjet tjera,
- Siguron sistem efikas komunikimi për të gjithë brenda institucionit,
- Përpunon dhe realizon protokole profesionale të trajtimit të pacienteve,
- Merr pjesë në studime kërkimore-shkencore profesionale,
- Ndërmerr masa për ngritjen e cilësive menaxhuese të aftësitë profesionale dhe kolektive në repart(njësi),
- Ushtron detyra plotësuese bazuar në kualifikimin e tij profesional dhe menaxhuese etj,
- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor bazuar në nivelin profesional që ka,
- Dhënia e këshillave profesionale me shkrim e me gojë rreth trajtimit të pacientit dhe përcaktimit të terapisë ditore,
- Përcakton radhën dhe planin e ekzaminimeve klinike-laboratorike,
- Sipas radhës punë në ambulancën për pacientët jashtëspitalor dhe bënë ekzaminimin-pranimin e tyre.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, si dhe dokumentet e kerkuara, bazuar në specifikat e institucionit :

- Diploma e Fakultetit të Mjekësisë;
- Licenca e Specialistit të lemisë përkatëse;
- Letërnjoftimi kopje
- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë trajnime të veçanta , si dhe njohuri të mira të funksionimit të sistemit shëndetësor të Kosovës;
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë, të ketë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim;
- Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme ndërsa njohja e gjuhës angleze është përparësi;
- Letërnjoftimi fotokopje

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat, kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave, dhe nuk janë të punësuar në sistemin publik shëndetësor.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e personelit të Spitalit Përgjithshëm të Ferizajt, rruga "Ramadan Rexhepi" p.n. Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Drejtori Ekzekutiv

Dr.Jeton Zeqiri



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerziteteska Bolnica i Klinicka Sluzba Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

Spitali Përgjithshëm Ferizaj(SPF) - Opsta Bolnica Urosevac(OBU) - Hospital General Ferizaj (HGF)

Direkcija Opšte bolnice u Urosevcu, na osnovu člana 8. Zakona o radu br.03 / L-212 i člana 4 Administrativnog uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o uređivanju postupaka za takmičenje u javnom sektoru, kao i čl. 5 Uredbe br. 1003/2016 o radnim odnosima HUCSK-a, kao i elektronsko odobrenje od 06.09.2019 od strane generalnog direktora HUCSK-a. 05.12.2019. Najavite ovo:

K O N K U R S

Institucija:	Opšta bolnica Urosevac
Naziv posla:	Lekari specijalista Oftalmolog
Funkcionalna kategorija / koefficient:	H-659
Nadzorni službenik:	Šef odeljenja
Trajanje:	Ncograničeno
Referentni broj:	922/19

• **One Specijalista oftalmologa (1)**

Glavna svrha posla:

Pružanje zdravstvenih usluga u kvalitativnom i kvantitativnom smislu na osnovu njihovog profesionalnog nivoa

Glavne odgovornosti lekara specijaliste:

- Zajedno sa šefom odeljenja i ostalim upravljačkim osobljem upravlja ljudskim resursima, opremom, objektima i zalihama do nivoa kojem pripada.
- Obezbeduje visoke standarde nege pacijenata.
- Tjubaznost, briga i poštovanje pacijenta i osoblja.
- Ljubaznost i profesionalna saradnja sa ostalim osobljem.
- Odgovarajući prijem, pregled i lečenje pacijenta.
- Redovno se registruje kroz medicinsku dokumentaciju (istorija bolesti, lctak, protokol itd.) Pacijenta.
- Redovno posećuje pacijente primljene u zdravstvenu ustanovu.
- Zahtevi za dodatne konsultativne posete,
- Nadgleda izvršavanje svakodnevnih zadataka radnog osoblja.
- Daje stručna mišljenja o radu koji on / ona obavlja.
- obavlja i druge dužnosti koje Supervisor zahteva za nesmetano odvijanje posla u ustanovi u kojoj je zaposlen.
- Obavlja određene zadatke kada je to potrebno u odnosu na usku specijalističku profesiju.
- odgovoran za razvijanje svog individualnog i kolektivnog nastavnog plana i programa na radnom mestu,
- angažuje radno osoblje u realizaciji svakodnevnih radnih zadataka,
- pruža i razvija programe i kurseve stručnog usavršavanja,
- Obavlja redovne revizije (inspekciju radnih mesta, opreme i inventara).
- Obezbeduje čisto i sigurno okruženje za sve
- Upravlja potrošnim materijalom i drugom opremom,
- Obezbeduje efikasan sistem komunikacije za svc unutar institucije,
- Razvija i izvršava profesionalne protokole lečenja pacijenata,
- učestvuje u stručnim naučno-istraživačkim studijama,
- Preduzeti mere za unapređenje upravljačkih kvaliteta stručne i kolektivne obuke u jedinici,
- Obavlja komplementarne dužnosti na osnovu svojih profesionalnih i menadžerskih kvalifikacija itd.
- pružanje kvalitetnih zdravstvenih usluga zasnovanih na profesionalnom nivou,
- Davanje pismenih i usmenih stručnih saveta o lečenju pacijenata i propisivanje dnevne terapije,
- utvrđuje redosled i plan kliničko-laboratorijskih pregleda,
- Naručite ambulanti rad u ambulantom okruženju i pregledajte ih i prihvatite ih.

Kvalifikacija, iskustvo, veštine i lične karakteristike, kao i potrebni dokumenti, zasnovani na specifičnostima institucije:

- Diploma Medicinskog fakulteta;
- Specijalistička licenca za dotičnu lemu;
- kopiraj ID
- Prednost će imati kandidati koji imaju specijalnu obuku, kao i dobro poznavanje funkcionisanja kosovskog zdravstvenog sistema;
- Demonstrisanje i efikasne veštine pismene i usmene komunikacije, poznavanje službenih jezika koji se koriste;
- Poznavanje računarskih veština je od suštinskog značaja dok je engleski prednost;
- Fotografska lična karta

Uslovi učesća u zapošljavanju: Svi kvalifikovani građani Republike Kosovo, koji su u potpunosti sposobni da deluju, imaju odgovarajuće obrazovanje, imaju profesionalnu sposobnost za obavljanje svojih dužnosti i nisu zaposleni u Republici Kosovo, mogu se prijaviti. sistem javnog zdravstva

Postupci konkursa: Konkurs je otvoren za svc zainteresovane kandidate.

Datum zatvaranja konkursa: 15 dana od dana objavljivanja u medijima.

Podnošenje prijave: prijave se primaju i dostavljaju kancelariji za osoblje Opšte bolnice Uroševac, ulica „Ramadan Rckhepi“ br.

Prijave podnete nakon završetka konkursa i nepotpune prijave neće biti prihvaćene.

Izvršni direktor

Dr Jeton Zeqiri

Çmimet në fushën e Trashëgimisë

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në përputhje me Rregulloren NR.09/2016 për Dhënien e Çmimeve në fushën e trashëgimisë kulturore, shpall:

KONKURS

Për çmimet që i ndan Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në fushën e trashëgimisë kulturore. Ftohen të interesuarit që të propozojnë kandidatët për Çmimin për Veprimtari Jetësore në fushën e trashëgimisë kulturore “Dea Dardanicae”, Çmimin Vjetor për Merita të Veçanta “Shtjefën Gjeçovi”, Çmimin Vjetor për Vepër Shkencore “Zef Mirdita” dhe Çmimin Vjetor për Menaxhim Institucional “Muhamed Shukriu”.

Çmimi për Veprimtari Jetësore në Fushën e Trashëgimisë Kulturore “Dea Dardanicae”

Ky Çmim u jepet personaliteteve të shquara, profesionistëve të dalluar, të cilët me angazhimin e tyre të vazhdueshëm kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në avancimin e trashëgimisë kulturore si dhe kanë nxitur të arriturat në mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Laureatë të këtij çmimi mund të jenë profesionistët, studiuesit dhe hulumtuesit në fushën e trashëgimisë kulturore, shtetas të Republikës së Kosovës dhe shtetas të vendeve të tjera.

Çmimi Vjetor për Merita të Veçanta “Shtjefën Gjeçovi”

Ky Çmim u jepet personaliteteve të dalluara në fushën e trashëgimisë kulturore, për angazhimin, kontributin dhe të arriturat përgjatë vitit për përmbushjen e detyrimit kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Laureatë të këtij çmimi mund të jenë profesionistët, studiuesit dhe hulumtuesit në fushën e trashëgimisë kulturore, shtetas të Republikës së Kosovës dhe shtetas të vendeve të tjera.

Çmimi Vjetor për Vepër Shkencore “Zef Mirdita”

Ky Çmim u jepet autorëve për vepër shkencore në fushën e trashëgimisë kulturore.

Laureatë të këtij çmimi mund të jenë profesionistët, studiuesit dhe hulumtuesit në fushën e trashëgimisë kulturore, shtetas të Republikës së Kosovës dhe shtetas të vendeve të tjera.

Çmimi Vjetor për Menaxhim Institucional “Muhamed Shukriu”

Ky Çmim u jepet udhëheqësve të institucioneve dhe punonjësve të institucioneve publike dhe jopublike që në mandat kanë mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Laureatë të këtij çmimi mund të jenë udhëheqësit dhe punonjësit e institucioneve publike dhe jopublike të institucioneve të trashëgimisë kulturore shtetas të Republikës së Kosovës.

Vlerësimin për dhënien e çmimeve e bën juria profesionale.

Konkurrimi për Çmimet në fushën e trashëgimisë kulturore mund të bëhet përmes propozimit nga:

Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës (për tri çmimet e para);

Institucionet e trashëgimisë kulturore;

Institutet shkencore, arkivat, muzetë;

Fakultetet e universiteteve publike si dhe private të Republikës së Kosovës;

Shoqatat dhe organizata që merren me trashëgimisë kulturore;

Personat fizikë dhe juridikë.

Propozimi duhet të përmbajë:

- Dokumentacion personal (kopje e dokumentit identifikues);
- Biografia me fokus në veprimtarinë për të cilin çmim nominohet;
- Dëshmitë relevante për kontributet e publikuara të të nominuarve (abstraktet e publikimeve nga fusha për të cilën nominohen, dëshmia dhe përmbajta e projekteve profesionale apo shkencore, vlerësimet dhe rekomandimet për kontribut në menaxhimin institucional në fushën për të cilën nominohet).

Propozimi duhet të nënshkruhet nga titullari që ka të drejtën e propozimit.

**Propozimet me shkrim duhet të dërgohen deri me 3 Janar 2020 në adresën:
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit /Departamenti Trashëgimisë Kulturore,
Zyra Nr. 22 Adresa : Sheshi “ Nëna Terezë “ Nr. 35, Prishtinë**

**Rregulloren mund ta gjeni në web faqen e Ministrise se Kultures, Rinise dhe Sportit:
www.mkrs-ks.org**

Nagrade iz oblasti kulturne baštine

Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, u podudarnosti sa Pravilnikom e BR.09/2016 za Dodelu Nagrada iz oblasti kulturne baštine, objavljuje:

KONKURS

Za nagrade koje dodeljuje Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta iz oblasti kulturne baštine. Pozivaju se zainteresovani da predlože kandidate za Nagradu za Životno Delo iz oblasti kulturne baštine “Dea Dardanicae”, Godišnje Nagrade za Posebne Zasluge “Shtjefën Gjeçovi”, Godišnje Nagrade za Naučno Delo “Zef Mirdita” i Godišnje Nagrade za Institucionalno Upravljanje “Muhamed Shukriu”.

Nagrada za Životno Delo iz oblasti Kulturne Baštine “Dea Dardanicae”

Ova se nagrada dodeljuje istaknutim ličnostima, istaknutim profesionalcima, koji su, svojim stalnim angažovanjem imali direktan uticaj u unapređenju kulturne baštine kao i, podstakli dostignuća u zaštiti, očuvanju i promovisanju kulturne baštine Kosova.

Laureati ove nagrade mogu biti profesionalci, naučnici i istraživači iz oblasti kulturne baštine, državljani Republike Kosova i državljani ostalih zemalja.

Godišnja nagrada za Posebne Zasluge “Shtjefën Gjeçovi”

Ova se nagrada dodeljuje istaknutim ličnostima iz oblasti kulturne baštine, za angažovanje, doprinos i dostignuća tokom godine, za ispunjavanje ustavnih i zakonskih obaveza za zaštitu, očuvanje i promovisanje kulturne baštine Kosova.

Laureati ove nagrade mogu biti profesionalci, naučnici i istraživači iz oblasti kulturne baštine, državljani Republike Kosova i državljani ostalih zemalja.

Godišnja nagrada za Naučno delo “Zef Mirdita”

Ova se nagrada dodeljuje autorima za naučno delo iz oblasti kulturne baštine.

Laureati ove nagrade mogu biti profesionalci, naučnici i istraživači iz oblasti kulturne baštine, državljani Republike Kosova i državljani ostalih zemalja.

Godišnja nagrada za Institucionalno Upravljanje “Muhamed Shukriu”

Ova se nagrada dodeljuje rukovodiocima institucija i radnicima javnih institucija koji u svom mandatu imaju zaštitu, očuvanje i promovisanje kulturne baštine.

Laureati ove nagrade mogu biti profesionalci, naučnici i istraživači iz oblasti kulturne baštine, državljani Republike Kosova i državljani ostalih zemalja.

Procenjivanje o dodeli nagrada vrši profesionalan žiri.

Konkuranje za Nagrade iz oblasti kulturne baštine mogu da se izvrše preko predlaganja od:

Akademije Nauke i Umetnosti Kosova (za tri prve nagrade);

Institucija kulturne baštine;

Naučnih Instituta, arhivat, muzeja;

Javnih fakulteta i univerziteta Republike Kosova;

Društava i organizacija koja se zauzimaju kulturnom baštinom;

Fizičkih i pravnih lica.

Predlog treba da sadrži:

- Ličnu dokumentaciju (kopija dokumenta za identifikovanje);
- Biografij sa fokusom na delatnosti za nagradu za koju se nominira;
- Relevantne dokaze za objavljene doprinose nominiranih (objavljeni abstrakti za oblast za koju se nominiraju, dokaz i sadržaj profesionalnih ili naučnih projekata, ocenjivanja i preporuke za institucionalno upravljanje iz oblasti za koju se nominira).

Predlog treba da se potpiše od titulara koji ima pravo na predlaganje.

**Pismeni predlozi mogu da se pošalju do 3 Januara 2020 na adresu:
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /Departman Kulturne Baštine,
kancelarija br. 22 Adresa : Trg “ Majke Tereze “ br. 35, Priština**

**Pravilnik u web stranici Ministarstva, Kulture, Omladine i Sporta
www.mkrs-ks.org**



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

